

Gordana Qetković

Tatjana Vojnov

Kultura muzikore 8

për klasën e tetë të shkollës fillore nëntëvjeçare

Manuali i mësuesit



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2009



Gordana Qetković Tatjana Vojnov

Kultura muzikore 8

për klasën e tetë të shkollës fillore nëntëvjeçare
MANUALI I MËSUESIT

Muzička kultura 8

Udžbenik za osmi razred devetogodišnje osnovne škole
PRIRUČNIK ZA NASTAVNIKE

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

Kryeredaktore dhe redaktore përgjegjëse: Nagja Durković

Redaktore: Mira Popović

Recensentë: Dr. Vesna Vuçiniq
 Mr. Vedrana Marković
 Sërgja Tmushiq
 Radovan Damjanović
 Zorica Damjanović

Përkthyes: Dimitrov Popović

Konsulent: Roland Guli, muzikolog

Redaktor teknik: Rajko Radulović

Për botuesin: Nebojša Dragović

Disenjo: Bilana Zhivković

Përpunimi grafik: Studio Mouse - Podgoricë

Shtypi:

Tirazhi:

ISBN

Këshilli i Arsimit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 04-3 -188 të datës 24. 8. 2007, e ka miratuar këtë komplet të Tekstit mësimor për përdorim në shkollat fillore nëntëvjeçare.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	5
MUZIKA KLASIKE	8
Karakteristikat e përgjithshme të muzikës në klasicizëm.....	8
FORMAT MUZIKORE TË KLASICIZMIT.....	10
Simfonia, sonata	10
Koncerti dhe format e muzikës së dhomës.....	11
OPERA NË KOHËN E KLASICIZMIT	13
PËRFAQËSUESIT E KLASICIZMIT VJENEZ	15
Franc Jozef Hajden	15
Wolfgang Amadeus Moxart	16
Kompozimi artistik: V. A. Moxart	
- <i>Atje do ma japësh dorën</i> , duet nga opera “Don Xhovani”	17
Ludvig van Bethoven	18
Kompozimi artistik: L. van Bethoven	
- <i>Odja e gëzimit</i> , nga Simfonia nr. 9, në d-mol	20
MUZIKA E ROMANTIZMIT	21
Karakteristikat e përgjithshme të muzikës në kohën e romantizmit	21
FORMAT MUZIKORE TË ROMANTIZMIT	23
PËRFAQËSUESIT E ROMANTIZMIT MUZIKOR NË GJYSMËN E PARË TË SHEKULLIT TË 19-të	24
Franc Shubert	24
Feliks Mendelson	26
Robert Shuman	27
Kompozimi artistik: R. Shuman - <i>Kënga e ushtarit</i>	28
Frederik Shopen	29



MUZIKA PROGRAMORE	30
Hektor Berlioz	30
Franc List	32
Kënga popullore: “O moj vajzë e gëzuar” (Oj, vesela veselice)	33
OPERA NË KOHËN E ROMANTIZMIT	34
Zhvillimi i operës italiane	34
Xhoakino Rosini, Xhuzepe Verdi	34
Verizmi në operën italiane	36
Pjetro Maskanji, Ruxhero Leonkavallo, Xhakomo Puçini	36
Zhvillimi i operës franceze	37
Xhakomo Majerber, Zhorzh Bize	37
Zhvillimi i operës gjermane	39
Karl Maria fon Veber, Rikard Vagner	39
Opereta	41
Zhak Ofenbah dhe Johan Shtrausi (Biri)	41
BALETI NË KOHËN E ROMANTIZMIT	42
Adolf Adam, Pjetër Iliç Çajkovski	42
Kënga popullore: “Është rritur në Novi portokalli”. (Uzrasla je u Novi naranča).	44
MUZIKA NË MAL TË ZI NË SHEKULLIN E 19-të	45
Kënga popullore “Shkapërceva dy-tri male”	46
LITERATURA	48

PARATHËNIE

Kompleti i teksteve mësimore për lëndën Kultura muzikore për klasën e 8-të përmban Tekstin mësimor dhe CD-në për nxënësit/nxënëset si dhe Manualin dhe CD-në për mësuesit/mësueset.

Manuali i mësuesit është si të thuash një mjet praktik ndihmës në planifikimin dhe zhvillimin e mësimimit sipas planit dhe programit të miratuar. Është treguar dhe paraqitur plani për çdo njësi mësimore, i punuar në formën e përgatitjes me detyrat e propozuara, mjetet mësimore të rekomanduara dhe metodat standarde.

Në Manual janë dhënë idetë themelore dhe instruksionet që mësuesi/ja do t'i plotësojë dhe zhvillojë më tej sipas predispozitave të veta. Metodika e mësimimit të Kulturës muzikore rinovohet dhe perfeksionohet në vazhdimësi, ndërsa mësuesit/et sipas mundësive të veta do t'i zbatojnë në praktikë. Në këtë kuptim, Manuali është menduar si një nga themelet në të cilat edhe më tej mund të perfeksionohen zgjidhjet metodike dhe të zhvillohen njohuritë dhe aftësitë pedagogjike

DËGJIMI I MUZIKËS

Dëgjimi i muzikës paraqet një proces shumë të rëndësishëm në përvetësimin e të gjitha njësive mësimore të lëndës Kultura muzikore. Në klasën e tetë të shkollës fillore nëntëvjeçare programi mësimor përmbledh rrjedhat e zhvillimit të muzikës klasike dhe një pjese të romantizmit. Përvetësimi i atij programi bazohet në dëgjimin e muzikës së epokave të përmendura. Në CD-ë janë vënë shembuj muzikorë të domosdoshëm që nxënësit të fitojnë një njohje mbi karakteristikat muzikore të epokave stilistike dhe formave muzikore që punohen dhe specifikat e tyre.

Shembujt muzikorë të zgjedhur, fragmentet nga veprat-format muzikore karakteristike për epokat që punohen, janë të dhëna karakteristike për periudhën e caktuar, formën muzikore ose krijimtarinë e kompozitorëve të veçantë.

Me dëgjimin e muzikës, nxënësit/et aftësohen që:

- të përshkruajnë përjetimin e vet të muzikës;
- të përshkruajnë atmosferën;
- të përcaktojnë llojin e muzikës;
- të përshkruajnë karakteristikat themelore të muzikës;
- të emërtojnë ekzekutuesit, instrumentet dhe orkestrat ekzekutuese.

Pas njohjes së nxënësit/es me veprat muzikore të periudhave të caktuara gjatë mësimimit, do të duhej që mësuesi/ja, me detyrat e dhëna të orientojë nxënësit/et për dëgjimin e shembujve të zgjedhur edhe jashtë procesit mësimor. Në këtë mënyrë nxënësit/et do të stimulohen që me iniciativën e vet të dëgjojnë muzikën artistike, të ndjekin koncertet dhe të marrin pjesë në ngjarjet e tjera muzikore si dhe të ndërtojnë kriteret e veta estetike.



EKZEKUTIMI I MUZIKËS

Duke qenë se të gjithë fëmijët nuk kanë predispozita natyrore të njëjta për ekzekutimin e muzikës dhe për këtë arsye, sigurisht, nuk do të mund të përvetësojnë përmbajtjet programore, është e domosdoshme që mësuesi/ja t'ia përshtatë punimin e njesisë mësimore mundësive objektive të fëmijëve.

Zhvillimi i aftësive interpretuese realizohet përmes:

- këndimit sipas partiturës me nota;
- ekzekutimit në instrumentet nga grupi i instrumenteve orfeane.

PROCEDIMI METODIK GJATË PUNIMIT TË KËNGËS SIPAS TEKSTIT ME NOTA

Klasa e tetë paraqet shkallën e dytë të ciklit të tretë të arsimimit fillor nëntëvjeçar në fushën e Kulturës muzikore. Në këtë klasë, nxënësit/et do t'i këndojnë këngët popullore dhe artistike sipas tekstit me nota.

Tek punimi i këngës sipas tekstit me nota po japim disa udhëzime të rëndësishme që duhen mbajtur parasysh për përvetësimin më të lehtë dhe më të mirë të këtij qëllimi operativ. Rëndësi të madhe, para së gjithash, ka pjesa hyrëse e procedimit metodik. Tek nxënësit/et duhet të nxitë kureshtjen dhe interesimin për pjesëmarrjen aktive në punimin e këngës.

Nxënësit/et duhet ta lexojnë tekstin e këngës që do të punohet. Nëse në të ka fjalë të panjohura, mësuesi duhet që t'i shpjegojë.

Përvetësimi i këngës sipas tekstit me nota fillon me analizën e tekstit me nota. Gjatë analizës, nxënësit /et njihen me kohën e këngës, me tonalitetin e këngës, vlerat e notave dhe figurat ritmike të përfaqësuara në këngë, shenjave për tempin dhe dinamikën, shenjave për përsëritje etj. Nëse në këngë ekzistojnë vlera ritmike të panjohura ose figura, madhësi të tonit, shenjave për dinamikë dhe temp ose disa shenja të tjera, mësuesi duhet që t'i shpjegojë.

Kur të përfundohet analiza e tekstit me nota, ritmi i këngës punohet në njërin nga rrokjet neutrale (na, la, ta) dhe pastaj futemi në leximin ritmik. Nëse ritmi është i thjeshtë dhe i qartë për të gjithë, ushtrimi në rrokjen neutrale mund të mos bëhet.

Leximi ritmik nënkupton leximin e notave sipas solfezhit me gjatësi të shënuara krahas taktimit të detyrueshëm.

Para këndimit të këngës me melodi, mësuesi duhet t'u kujtojë nxënësve se duhet mbajtur qëndrimi i drejtë dhe frymëmarrja e duhur gjatë këndimit. Për t'u kënduar mund të përdoren modele të ndryshme të cilat në mënyrë sekueente, përsëriten me radhë në gradët e shkallës muzikore në të cilën është shkruar kënga. Pas kësaj, kënga duhet përvetësuar sipas frazave ose tërësive të shkurtra, gjithnjë deri sa nxënësit/et t'i mësojnë si duhet. Nëse ndodh që nxënësit/et gabojnë gjatë këndimit, mësuesi/ja duhet t'i ndalojë dhe t'i korrigjojë. Këndimi sipas tekstit me nota duhet të jetë i përcjellë me taktim. Pas kësaj, futen në këndimin e këngës me tekst.

Gjatë punës duhet të kihet parasysh të kënduarit ekspresiv; kënga ekzekutohet në tempin përkatës me vokale të formuara dhe artikulum të theksuar, me dinamikë dhe agogjikë.

ANALIZA E FORMËS SË KËNGËS

Gjatë punimit të këngës, mësuesi/ja duhet t'i nxitë nxënësit që të dallojnë formën e këngës së punuar, në kuadër të njohurive të tyre të fituara më parë. Meqenëse shumica e këngëve popullore, sipas ndërtimit të vet, nuk i përgjigjet formave klasike muzikore, gjatë punimit të këngëve popullore nuk duhet të insistojmë në definimin e tyre.

FORMIMI I GRUPEVE

Formimi i grupeve gjatë punimit të këngës mund të bëhet zgjidhje rastësisht ose qëllimisht. Gjatë kësaj do të duhej të kihej parasysh që grupet, çdo herë të formohen në mënyrë të ndryshme.

Kur i formojmë grupet qëllimisht, mësuesi/ja përcakton përbërjen e tyre. Tek formimi qëllimisht, grupi duhet të ketë parasysh mundësitë e nxënësve/eve (këndimi ekspresiv, ndjenja e ritmit, aftësia e ekzekutimit).

Detyrat që u jepen grupeve duhet të jenë të barabarta dhe të ndërtuara ashtu që nga nxënësit/et të kërkojnë punë aktive.

Kur grupet duhet të raportojnë për punën e vet, zgjidhet përfaqësuesi i grupit. Përfaqësuesi i grupit mund të zgjidhet rastësisht ose qëllimisht, ndërsa detyra e tij është të njoftojë për punën e grupit që ai përfaqëson.

AKTI KRIJUES

Me dëgjimin me përjetim dhe analitik të muzikës, ekzekutimin kolektiv dhe individual të shembujve të zgjedhur muzikorë, nxënësit stimulohen për punë krijuese. Përveç kësaj, përjetimin individual të muzikës, nxënësit/et mund ta shprehin edhe me paraqitje figurative dhe tekstuale ose lëvizje spontane dhe përfytyrimin e përcjelljes ritmike në kompozimet që këndojnë dhe dëgjojnë. Sipas predispozitave natyrore dhe mundësive të nxënësve/eve, mësuesi/ja i udhëzon në punën me grupe kolektive ose individuale.

MJETET E NEVOJSHME PËR REALIZIMIN E MËSIMIT

Që të realizohen programet mësimore, është e nevojshme që çdo kabinet për zhvillimin e mësimin të lëndës Kultura muzikore të jetë i përgatitur me instrumente akustike (piano, fizarmonikë, kitarë), më një instrument elektrik (sintetitazor, kitarë elektrike), instrumente orfeane, CD-player, televizor dhe DVD-player, fotografi në mur të instrumenteve, orkestrave, ndërtesave, figurave, skulpturave dhe vlerave të tjera të kulturës materiale, të lidhura për çdo epokë historike të stilit.



MUZIKA E KLASICIZMIT

Karakteristikat e përgjithshme të muzikës në klasicizëm

Qëllimi i orës mësimore:

Fitimi i njohurive për muzikën në kohën e klasicizmit

Dëgjimi i muzikës:

1. J. S. Bah - *Koncerti i Brandenburgut nr.3*, G-dur (fragment, koha I)
2. V. A. Moxart- *Simfonia nr. 40*, g-mol, (fragment, koha I)
3. V. A. Moxart- *Sonatë për piano*, K.V.310, C-dur (fragment, koha I)

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi analitik dhe bisedë për kompozimin e dëgjuar të V. A. Moxartit
3. dëgjimi i sonatës për piano në a-mol të V. A. Moxartit dhe bisedë për instrumentin
4. formimi dhe njoftimet e grupeve

1. Dëgjohet fragmenti nga koha I e “*Koncertit të Brandenburgut*” të J. S. Bahut. Në bazë të shembullit të dëgjuar, të kontrollohet nëse nxënësit i kanë përsëritur njohuritë e fituara për muzikën e barokut. Kërkon të dallojnë formën (koncert) dhe të thonë veçoritë sipas të cilave njohin epokën (shenjat dalluese të muzikës së barokut: madhështore, festive, me ritëm motorik). Të bisedohet për muzikën instrumentale të barokut mbi bazën e njohurive të fituara në klasën e mëparshme.

2. Dëgjohet fragmenti nga “*Simfonia në b-mol*”, nr. 40 e Moxartit. Pyeten nxënësit/et se si e përjetojnë këtë muzikë dhe u vë si detyrë të vërejnë se në çfarë dallojnë nga kompozimi i mëparshëm (tempi, karakteri). Kërkon nga nxënësit që të përshkruajnë atmosferën që krijon ajo. Të shkruhet në tabelë V. A. Moxart, *Simfonia në g-mol*, nr. 40, koha I, gjysma e dytë e shekullit të 18-të. Mbi bazën e materialit që ka në dispozicion (fotografi, posterë) paraqet ndërtesat nga koha e klasicizmit, pikturat, skulpturat, me qëllim që nxënësit të bëjnë dallimin mes epokës të barokut dhe asaj të klasicizmit.

Dëgjon përsëri një fragment nga “*Simfonia në g-mol*” e Moxartit. Fut nxënësit të vërejnë se si është melodia kryesore në të dhe shoqëruesja e saj. I informon se një mënyrë e tillë kompozimi quhet homofoni dhe kërkon ta krahasojnë me mënyrën e kompozimit në barok- polifoninë. Përsëri lëshon shembullin me detyrën që të vërejnë me kujdes melodinë, duke kërkuar nga nxënësit/et të dallojnë veçoritë e saj, ndërtimin, se është në pjesë, dhe e krahasojnë me melodinë e koncertit të Brandenburgut, e cila është e pandashme. Kërkon nga nxënësit të përpiqen ta këndojnë melodinë nga simfonia e Moxartit, të cilën e kanë dëgjuar dhe të përfundojnë se melodia mbahet mend lehtë, e kundërta me atë të melodive të barokut.

Përsëri dëgjohet shembulli, me qëllim që nxënësit/et të vërejnë lëvizjet dinamike, rritjen dhe zvogëlimin gradual të zërit. Në bazë të kësaj të nxirret konkluzioni për karakteristikat e muzikës

së klasicizmit. Nxënësit/et pastaj, nga libri, njihen me kushtet ekonomike-shoqërore në të cilat u formua stili i ri në muzikë dhe karakteristikat e tij në kohën e klasicizmit.

Kërkon nga nxënësit të vënë re se për cilën përbërje flitet dhe i fut të përfundojnë se ai është grupi instrumental që quhet orkestër. Gjatë dëgjimit i nxit të dallojnë instrumentet që dëgjojnë në orkestër dhe pastaj i informon për përbërjen e orkestrës klasike duke e treguar në fotografinë në mur. I njeh me karakteristikat e tjera të klasicizmit në muzikë (zhvillimi i ciklit dhe formës së sonatës) dhe i informon për format e tjera të muzikës instrumentale të klasicizmit (koncerti, format e ndryshme kamertale).

3. Lëshohet shembulli i muzikës pianistike: V. A. Moxart, *Sonata për piano në C-dur*, me detyrën që të njohin instrumentin, të thonë llojin të cilit i përket (instrument me tela me tastierë). Të përmendë instrumentet me të prekur, nga epoka e mëparshme dhe i krahasojnë me pianon (ngjashmëritë dhe dallimet). I pyet nxënësit, nëse pianoja është instrument i ri i kohës së klasicizmit apo ka ekzistuar edhe në kohën e barokut. Njeh nxënësit me rëndësinë e pianos në epokën e muzikës së klasicizmit. Të shkruhet në tabelë emërtimi i kompozimit dhe fut nxënësit të kujtojnë formën e sonatës, me të cilën janë njohur dhe informuar në klasën e gjashtë.

4. I ndan nxënësit/et në disa grupe me detyrën që në bazë të dëgjimit të fragmentit nga koncerti i Brandenburgut dhe simfonisë së Moxartit të thonë veçoritë e muzikës së barokut dhe muzikës së klasicizmit dhe t'i krahasojnë. Pas bisedës së nxënësve në kuadër të çdo grupi, përfaqësuesit e grupeve njoftojnë për dijenitë deri tek të cilat kanë ardhur.

Pamja e tabelës:

Klasicizmi

- Gjysma e dytë e shekullit të 18-të dhe fillimi i shekullit të 19-të
- V. A. Moxart: Simfonia në g-mol, nr. 40, koha I
- Sonata për piano në C-dur, K.V. 310, koha I

Muzika e klasicizmit

Karakteristikat e përgjithshme:

- meloditë që ndahen
- kalimet dinamike graduale
- homofonia

Format e reja muzikore:

- cikli i sonatës
- forma e sonatës

Instrumenti udhëheqës solistik:

- piano

Orkestrat instrumentale

- formimi i orkestrës klasike
- format e ndryshme të muzikës së dhomës



FORMAT MUZIKORE TË KLASICIZMIT

Simfonia, sonata

Qëllimi i orës mësimore:

Arritja e njohurive për format e reja muzikore: sonata dhe simfonia

Dëgjimi i muzikës:

1. V. A. Moxart – *Sonata për piano në c-mol*, nr. 14, KV 457 (koha I)
2. F. J. Hajden – *Simfonia nr. 94*, G-dur (koha II)

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi analitik i sonatës
3. dëgjimi analitik i simfonisë
4. krahasimi i formave të analizuara

1. Në pjesën hyrëse të orës, lëshohet fragmenti nga koha I e *Sonatës për piano në c-mol*, nr. 14, KV 457, koha I e V. A. Moxartit dhe kërkohet nga nxënësit/et që të njohin se për cilin instrument është shkruar. Bisedohet për karakterin e fragmentit të dëgjuar dhe shkruhet në tabelë emri i kompozitorit dhe emërtimi i kompozimit.

2. Dëgjohej e gjithë koha dhe kërkohet nga nxënësit/et që pas dëgjimit të vërejnë rrjedhën e pjesës pianistike (çfarë karakteri është, si është rrjedha e saj melodike), në se ka zbulurime karakteristike melodike (trila). Përsëri dëgjohej fragmenti dhe kërkohet nga nxënësit/et të dallojnë temat, t'i përshkruajnë si edhe të vërejnë pjesët e formës së sonatës (ekspozicionin, pjesën zhvillimore dhe përsëritjen).

Pas kësaj, nxënësit/et informohen vetë për karakteristikat e sonatës nga Teksti mësimor, si edhe për formën klasike të sonatës (ekspozicionin, pjesën zhvillimore dhe përsëritjen) dhe ciklin e sonatës.

3. Të dëgjohej fragmenti i kohës II të *Simfonisë nr. 94*, në G-dur të F. J. Hajdenit dhe bisedohet me nxënësit/et për përjetimin dhe i pyet në se kanë pasur një formë të ngjashme në orën e mëparshme (formën e simfonisë nxënësit e kanë dëgjuar në orën e kaluar). Kërkon nga ata të dallojnë instrumentet me të cilat ekzekutohet kompozimi. Të shkruhet në tabelë F. J. Hajden - *Simfonia nr. 94*, G-dur dhe shekulli kur ka jetuar kompozitori, pa shkruar kohën, për të cilën është fjala.

Përsëri dëgjohej fragmenti dhe pastaj ata njihen me të gjitha karakteristikat e simfonisë nga Teksti mësimor. Pastaj mësuesi/ja duhet të orientojë nxënësit të gjejnë se për cilën kohë flitet, në bazë të tempit në të cilin është shkruar. Pastaj nxënësit/et, në bazë të paraqitjes grafike të ciklit të sonatës në Libër, shikojnë ndërtimin e kohëve në ciklin e sonatës.

4. Dëgjohej në mënyrë të alternuar fragmente simfonie dhe sonate dhe kërkohet nga nxënësit/et që t'i krahasojnë (numrin e kohëve dhe ndërtimin e tyre, instrumentin dhe orkestrën që ekzekuton sonatën dhe simfoninë).

Pamja e tabelës:

V. A. Moxart, Sonata për piano në c-mol, nr. 14 KV 457

sonata klasike – formë muzikore me tri ose katër kohë, e shkruar për një instrument (më shpesh piano) ose dy instrumente – duo sonate (më shpesh për violinë dhe piano ose violonçel dhe piano).

F. J. Hajden, Simfonia në G-dur nr. 94

simfonia - formë muzikore me tri ose katër kohë, me vëllim më të madh, e shkruar për orkestër simfonike

cikli i sonatës – emërtimi për format muzikore të shkruara në shumë kohë

forma e sonatës – koha e parë e ciklit të sonatës, që përbëhet nga ekspozicioni, pjesa zhvillimore dhe përsëritja ose repriza.

Koncerti dhe format e muzikës së dhomës

Qëllimi i orës mësimore:

Fitimi i njohurive për format e reja muzikore - koncerti dhe format muzikore të shkruara për orkestra më të vogla.

Dëgjimi i muzikës:

1. A. Vivaldi – *Katër stinët e vitit*, koncerti për violinë *Pranvera* (fragment)
2. V. A. Moxart – *Koncert për piano dhe orkestër në C-dur*, nr. 21, koha I (fragment)
3. L. van Bethoven - *Koncert i harqeve në c-mol*, nr. 4, koha I (fragment)

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi analitik i koncertit
3. dëgjimi analitik dhe me përjetim i kuartetit të harqeve
4. krahasimi i formave të analizuara

1. Në pjesën hyrëse të orës, nxënësve/eve u lëshohet të dëgjojnë një fragment nga koha I e Koncertit për violinë dhe orkestër (*Pranvera*) të A. Vivaldit nga përmbledhja “*Katër stinët e vitit*” dhe i pyet se a e kanë të njohur atë kompozim (e kanë dëgjuar në klasën e mëparshme). Kërkon që ta njohin instrumentin solistik (violinën) dhe grupimin instrumental (orkestrën) dhe të thonë se cilit lloji i përket kompozimi (muzikë instrumentale, koncert). Shkruan në tabelë: A. Vivaldi - *Katër stinët e vitit*, *Koncert për violinë (Pranvera)*, koha I.



2. Dëgjojnë fragmentin e *Koncertit për piano dhe orkestër në C-dur*, koha I, nr. 21. të

V. A. Moxartit. Kërkon nga nxënësit të njohin instrumentin me të cilin ekzekutohet kompozimi (piano) dhe grupimi instrumental (orkestra). Bisedohet se si e kanë përjetuar ata pas dëgjimit.

Pas kësaj kërkon nga nxënësit/et të krahasojnë fragmentin e dëgjuar me të mëparshmin (A. Vivaldi) dhe të thonë se cilat janë dallimet dhe ngjashmëritë mes këtyre dy kompozimeve (instrumentet me të cilat ekzekutohen, shenjat melodike, karakteri i kompozimit). Pas krahasimit të këtyre dy koncerteve nga kohë të ndryshme, i pyet nxënësit/et se në cilën nga format e mësuara i përkujton kjo pjesë (concerto grosso), pa marrë parasysh pjesëmarrësit në ekzekutim (solisti dhe orkestra). U vë detyrë nxënësve/eve që vetë ata të nxjerrin karakteristikat bazë të koncertit në kohën e muzikës së klasicizmit, duke e krahasuar me koncertin barokian.

Dëgjojnë përsëri fragmentin nga koha I, duke e përqendruar vëmendjen e nxënësve në marrëdhënien mes solistit dhe orkestrës. I pyet nxënësit/et se kush gjatë ekzekutimit e ka lëvizshmërinë melodiko-ritmike më të madhe, solisti apo orkestra (solisti), debutimi i tyre a u kujton takimet apo jo, dhe mbi ç' bazë konkludojnë ashtu. Pas kësaj, mësuesi/ja i fut që pas dëgjimit të muzikës të njohin karakteristikat e veçanta të formës së sonatës tek koncerti në lidhje me formën e sonatës tek sonata dhe simfonia: ekspozicioni i dyfishtë dhe kadenca. Shkruan në tabelë : V. A. Moxart- *Koncert për piano dhe orkestër në C-dur*, koha I. Nxënësit/et pas kësaj njihen me karakteristikat e koncertit nga Teksti mësimor.

3. Lëshon një fragment nga *Kuarteti i harqeve në c-mol*, koha I, nr. 4 të L. van Bethovenit. Bisedon me nxënësit/et mbi emocionet gjatë dëgjimit dhe karakterin e fragmentit të dëgjuar. Kërkon nga nxënësit të njohin instrumentet me të cilat ekzekutohet ky kompozim (instrumentet me hark). I informon për emërtimin e një orkestre të tillë instrumentale (kuarteti i harqeve) dhe përbërjes së tij (2 violina, viola dhe violonçeli). Kërkon që volumi i zërit i kuartetit të harqeve të krahasohet me zërin e orkestrës simfonike.

Lëshohet përsëri incizimi i fragmentit të *Kuartetit të harqeve në c-mol*, koha I, pas të cilit mësuesi/ja duhet t'u bëjë me dije nxënësve/eve se kuarteti i harqeve i shkruar në formën e ciklit të sonatës, koha e parë e të cilit është gjithashtu, si tek sonata, simfonia dhe koncerti i shkruar si formë e sonatës.

Të shkruhet në tabelë L. van Bethoven - *Kuarteti i harqeve nr. 4*, në c-mol, koha I. Pastaj kërkon nga nxënësit/et të përsërisin përbërjen e kuartetit të harqeve dhe i njeh me përbërje të tjera tipike për këtë periudhë kohore, siç është p.sh. trio pianistike (violina, violonçeli dhe pianoja). Të shpjegohen termat: përbërja e orkestrës së muzikës së dhomës, muzika e dhomës dhe orkestra e muzikës së dhomës.

4. Dëgjojnë në mënyrë të alternuar fragmentet e koncertit dhe të kuartetit të harqeve dhe kërkon nga nxënësit/et që t'i krahasojnë (numri i kohëve dhe ndërtimi i tyre, përbërja instrumentale që ekzekuton koncertin dhe kuartetin e harqeve).

Pamja e tabelës:

Koncerti klasik – një formë e madhe muzikore me tri kohë, e shkruar për një instrument solistik dhe orkestër.

Format e muzikës së dhomës: kuarteti i harqeve dhe trio pianistike.

OPERA NË KOHËN E KLASICIZMIT

Qëllimi i orës mësimore:

Fitimi i njohurive mbi zhvillimin e operës në kohën e klasicizmit

Dëgjimi i muzikës:

1. H. Persell - aria “*Vajtimi i Didonës*” nga opera “*Didona dhe Eneu*”
2. K. V. Gluk – aria e *Orfeut* nga opera “*Orfeu dhe Euridika*”
3. V. A. Moxart – aria e *Mbretëreshës së natës* nga opera “*Flauti magjik*”

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi dhe analiza e aries së *Orfeut* nga opera “*Orfeu dhe Euridika*” e Glukut
3. dëgjimi dhe analiza e aries “*Mbretëresha e natës*” nga opera “*Flauti magjik*”
4. formimi i grupeve dhe raportimet

1. Në pjesën hyrëse të orës, nxënësit dëgjojnë arien “*Vajtimi i Didonës*” nga opera “*Didona dhe Eneu*” të Henri Persllit, të cilën e kanë dëgjuar në orën e kaluar. Kërkon prej tyre që të kujtojnë se flitet për arien e operës, që paraqet një pjesë nga opera “*Didona dhe Eneu*”. Mësuesi inicon bisedën me nxënësit/et për operën që e kanë dëgjuar në klasën e mëparshme. Përmes bisedës nxënësit do të kujtohen se tema e operës që dëgjuan është marrë nga miti antik, si dhe në karakteristikat e operës së barokut (virtuozitet i tepruar, pa logjikë dhe pa lidhje mes muzikës dhe veprimit dramatik).

2. Pas aries nga opera “*Didona dhe Eneu*”, dëgjojnë arien e *Orfeut* nga opera “*Orfeu dhe Euridika*” të K. V. Glukut. Pyet nxënësit/et si e përjetojnë këtë arie, a ndryshon ajo nga e mëparshme apo ngjason me të (e trishtuar dhe e qetë) dhe a shfaqet Orfeu në ndonjë pjesë tjetër operistike që kanë mësuar (opera *Orfeu* e kompozitorit të barokut Klaudio Monteverdi) me të cilën janë njohur në klasën e mëparshme. Njëri nga nxënësit/et do të lexojë libretin dhe me komente të përbashkëta do të vinë deri tek përfundimi se përmbajtja e operës është një mit antik. Mësuesi/ja pastaj do t’u kujtojë nxënësve dekadencën e operës në gjysmën e dytë të shekullit të 17-të dhe në gjysmën e parë të shekullit të 18-të dhe kërkesën e disa shpirtrave të përparuar që të bëhet reforma e operës.

Dëgjohet edhe një herë fragmenti i aries dhe kërkohet nga nxënësit që të komentojnë melodinë dhe ritmin. I fut, gjatë kohës së dëgjimit, të përcjellin tekstin me nota në Libër.

Pastaj u thotë se këtë arie e ka shkruar Gluku dhe i njeh me elementet e reformës së operës që e ka realizuar ai. Shkruan në tabelë: K. V. Gluk – aria e *Orfeut* nga opera “*Orfeu dhe Euridika*”.



3. Dëgjohet aria “*Mbretëresha e natës*” nga opera “*Flauti magjik*” të V.A. Moxartit. I pyet nxënësit si e përjetojnë arien dhe kërkon nga ata që ta krahasojnë me arien e mëparshme (arie e Orfeut nga opera “*Orfeu dhe Euridika*”) sipas karakterit dhe shenjave melodiko-ritmike. T’ua bëjë të qartë se operën e ka kompozuar njëri nga përfaqësuesit më të mëdhenj të muzikës së klasicizmit, V. A. Moxarti. Të shkruhet në tabelë: V. A. Moxart, aria e *Mbretëreshës së natës* nga opera “*Fyelli magjik*”. Udhëzon nxënësit të përcjellin tekstin me nota në Tekstin mësimor, gjatë kohës së dëgjimit. Të njohë nxënësit me atë se kjo arie është shembull tipik i aries koloraturale si dhe i informon ç’është koloratura. Njëri nga nxënëset/et do të lexojë libretin e operës dhe me komentime të përbashkëta duhet të vijnë tek përfundimi se si është përmbajtja (fantastike dhe përrallore) dhe cili është ndryshimi në krahasim me libretin e operës së Glukut (miti antik).

Duke shfrytëzuar Tekstin mësimor, nxënësit do të informohen vetë për krijimtarinë operistike të Moxartit.

4. Ndan nxënësit/et në 4-6 grupe, në varësi nga numri i nxënësve/eve në paralele, me detyrën që grupi i parë të nxjerrë si e sheh ai operën “*Orfeu dhe Euridika*”, grupi i dytë operën “*Flauti magjik*”, grupi i tretë të bëjë krahasimin mes dy operave, grupi i katërt të thotë mendimin e vet për krijimtarinë operistike të Moxartit, grupi i pestë mendimin e vet për krijimtarinë e Glukut, ndërsa grupi i gjashtë të japë shikimin e vet për operën, si formë.

Pamja e tabelës:

Karakteristikat e reformës së operës:

- rrjedhë logjike dhe e vazhdueshme e veprimit dramatik;
- përshtatje e muzikës me veprimin dramatik;
- lidhja e uverturës me përmbajtjen e operës;
- recitativi seko dhe recitativi akompanjato

K. V. Gluk – gjysma e dytë e shekullit të 18-të, reformatori i operës

– Orfeu dhe Euridika

Opera klasike:

- opera serioze, opera komike
- përmbajtja: mitet antike dhe legjendat, tregime nga jeta e përditshme, përralla
- veprimi dramatik: në vazhdimësi dhe funksional
- muzika: e përputhur me rrjedhën e veprimit dramatik
- roli i korit dhe i orkestrës i përshtatur me veprimin e dramës

V. A. Moxart – gjysma e dytë e shekullit të 18-të, kompozitori më i rëndësishëm i muzikës së klasicizmit.

- Flauti magjik

PËRFAQËSUESIT E KLASICIZMIT VJENEZ

Franc Jozef Hajden

Qëllimi i orës mësimore:

Fitimi i njohurive mbi jetën dhe krijimtarinë e F. J. Hajdenit

Dëgjimi i muzikës:

1. F. J. Hajden: *Simfonia në D-dur*, nr. 104, *Londinezë*, koha I, fragment
2. F. J. Hajden: *Sonata për piano në E-dur*, nr.52, koha III, fragment

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi analitik i muzikës së F. J. Hajdenit dhe njohja me jetën dhe krijimtarinë e tij
3. formimi i grupeve dhe raportimi

1. Në pjesën hyrëse të orës të dëgjohej një fragment nga koha I e simfonisë në D-dur- *Londinezet*. Kërkon nga nxënësit të thonë se cila është forma e kompozimit të dëgjuar mbi bazën e njohurive që kanë fituar më parë për simfoninë në kapitullin “Format muzikore të klasicizmit” dhe kërkon prej tyre të thonë se cilat janë karakteristikat themelore të simfonisë (numri i kohëve, karakteri, tempi).

2. Pas pjesës hyrëse të vazhdohej përsëri me dëgjimin e kohës së parë të simfonisë. Kërkohej nga nxënësit të përshkruajnë fillimin e simfonisë (zëvendësimi i pjesëve që këndohen). Të shkruhet në tabelë emri i kompozitorit, shekulli në të cilin ka jetuar dhe emërtimi i kompozimit. T’u thuhet se Hajdeni ka qenë i frymëzuar gjatë qëndrimit në kryeqytetin e Anglisë dhe se kjo simfoni është krijuar nën atë ndikim. Pas kësaj, nxënësit duhet që nga Teksti mësimor të informohen për jetën dhe krijimtarinë e F. J. Hajdenit dhe të interesimeve të tij për folklorin muzikor që e ka shfrytëzuar në veprat e veta. Dëgjohej edhe një herë fragmenti dhe u jep detyrë nxënësve që të njohin temën e parë dhe të dytë të formës së sonatës dhe kërkon nga ata të përshkruajnë karakterin e tyre (tema I: dramatike dhe me temp të ngadaltë, tema II: lirike dhe me temp të shpejtë).

Pas kësaj të lëshohet një fragment nga koha III e *Sonatës për piano në E-dur* dhe u kërkon nxënësve që të bëjnë dallimin në mes këtij kompozimi dhe atij të mëparshmit (kompozimi për piano në formë sonate). I pyet se cilat janë karakteristikat e sonatës (numri i kohëve, forma e tyre, tempi).

3. Meqenëse janë dëgjuar simfonia dhe sonata të shkruara në trajtën e formës së sonatës, të formohen shumë grupe nxënësish/esh me detyrën që njëri grup të bëjë paraqitjen grafike të ciklit të sonatës, grupi i dytë, mbi bazën e njohurive të fituara, të bëjë paraqitjen grafike të formës së sonatës, grupi i tretë të shqyrtojë të dhënat mbi jetën e Hajdenit, grupi i katërt për krijimtarinë e Hajdenit, ndërsa grupi i pestë dhe i gjashtë të komentojnë, nëse anëtarët e katër grupeve të para i kanë kryer si duhet detyrat.



Pamja e tabelës:

F. J. Hajden, kompozitor austriak, përfaqësues i klasicizmit vjenez, gjysma e dytë e shekullit të 18-të

- simfonia në D-dur, nr. 104, *Londineze*, koha I
- sonata në piano në E-dur, nr. 52, koha III
- krijimtaria: simfonitë, kuarteti i harqeve, sonatat pianistike, oratoriumi

Wolfgang Amadeus Mozart

Qëllimi i orës mësimore:

Fitimi i njohurive për jetën dhe krijimtarinë e V. A. Mozartit

Dëgjimi i muzikës:

1. V. A. Mozart: *Aria e Mbretëreshës së natës* nga opera “Flauti magjik”
2. V. A. Mozart: *Simfonia në C-dur*, nr. 41, *Jupiteri*, koha I, fragment
3. V. A. Mozart: *Koncert për piano dhe orkestër në d-mol*, nr. 20, koha I, fragment

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi analitik i muzikës së V. A. Mozartit dhe njohja me jetën dhe krijimtarinë e tij.
3. formimi i grupeve

1. Në pjesën hyrëse të orës të dëgjohet aria “*Mbretëresha e natës*” nga opera “Flauti magjik” dhe kërkon nga nxënësit që përmes bisedës për operën në kohën e klasicizmit dhe përfaqësuesit e saj të vijnë vetë tek emri i autorit që ka kompozuar këtë arie. Kur të përgjigjen se është fjala për V. A. Mozartin, e shkruajnë në tabelë emrin e kompozitorit.

2. Dëgjojnë fragmentin nga koha I e Simfonisë së Mozartit në C-dur, nr. 41, *Jupiteri*. Përmes fragmentit të dëgjuar të simfonisë, kërkon nga nxënësit të përgjigjen se cili është karakteri i fragmentit të dëgjuar (luftarak dhe energjik). I pyet nxënësit, nëse e kanë të njohur formën, meqenëse në orën e mëparshme e kanë dëgjuar fragmentin nga simfonia e Hajdenit. Kërkon nga nxënësit që të krahasojnë fragmentet e simfonisë së Hajdenit me atë të Mozartit (karakterit i simfonisë së Hajdenit dhe të Mozartit është i njëjtë, si edhe karakteret e temës së I dhe të II; tema e I luftarake, ndërsa tema e dytë lirike). Të shkruhet në tabelë emërtimi i kompozimit.

Dëgjohet përsëri fragmenti dhe kërkohet nga nxënësit që të dallojnë përsëri temën I dhe të II, i krahasojnë sipas karakterit duke thënë edhe karakteristikat e formës muzikore.

Dëgjojnë fragmentin nga koha I të *Koncertit për piano dhe orkestër në d-mol*, nr. 20. Pas dëgjimit të parë nxënësit/et duhet të dallojnë instrumentet që marrin pjesë në ekzekutimin e kësaj pjese muzikore (piano dhe orkestër). Kërkon nga nxënësit që gjatë kohës së dëgjimit, të përcjellin tekstin e notave të fragmentit të temës I të koncertit në Tekstin mësimor dhe të thonë se për cilën formë të muzikës instrumentale është fjala (koncert për piano dhe orkestër). Kërkon nga nxënësit që të tregojnë se çfarë karakteri është tema I e koncertit (dramatike). Shkruan në tabelë emërtimin e kompozimit. Udhëzon nxënësit/et që pas dallimit të formës të japin përshkrimin e përjetimit të vet për fragmentin e dëgjuar nga koha I e koncertit. Nxënësit/et informohen vetë nga Teksti mësimor për jetën dhe krijimtarinë e V. A. Moxartit.

3. I ndan nxënësit në shumë grupe. Grupi i parë duhet të shqyrtojë të dhënat për jetën e Hajdenit, grupi i dytë për jetën e Moxartit, grupi i tretë për krijimtarinë e Hajdenit, i katërti për krijimtarinë e Moxartit, i pesti të dëgjojë kompozimet e Hajdenit që janë kaluar gjatë orës mësimore, ndërsa grupi i gjashtë kompozimet e Moxartit. Grupet që janë marrë me njërin kompozitor u bëjnë pyetje nxënësve/eve të grupeve që janë marrë me kompozitorin tjetër. Përgjigjet e sakta dhe të plota fitojnë pikë dhe në fund shpallet grupi më i mirë.

Pamja e tabelës:

V. A. Moxart, kompozitor austriak, përfaqësues i klasicizmit vjenez, gjysma e dytë e shekullit të 18-të.

- simfonia në C-dur, nr. 41, *Jupiteri*
- koncert për piano dhe orkestër në d-mol. nr. 20
- krijimtaria: simfonitë, sonatat, kuarteti i harqeve, operat, koncertet

V. A. Moxart: Atje do ma japësh dorën, duet nga opera “Don Xhovani”

Qëllimi i orës mësimore:

Mësimi i këngës sipas partiturës me nota

Dëgjimi i muzikës:

1. V. A. Moxart – aria” *Mbretëresha e natës*” nga opera “*Flauti magjik*”
2. V. A. Moxart – *Atje do ma japësh dorën*, duet nga opera “*Don Xhovani*”

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. punimi i këngës “*Atje do ma japësh dorën*”, sipas partiturës me nota
3. formimi i grupeve



4. këndimi i duetit me përcjelljen me piano nga mësuesi
5. përfytyrimi i lëvizjeve dhe i mimikës gjatë ekzekutimit të duetit
6. dëgjimi i muzikës

1. Dëgjojnë arien “Mbretëresha e natës” dhe kërkohet nga nxënësit të njohin arien, meqenëse e kanë dëgjuar në orën kushtuar operës në kohën e klasicizmit. Kërkohet nga ata të thonë se nga cila operë është kjo arie, të thonë karakteristikat (kolaturale) të saj dhe emrin e kompozitorit. Mësuesi pastaj do të njoftojë mësimin e këngës së re sipas partiturës me nota dhe shkruan në tabelë emërtimin e kompozimit dhe emrin e kompozitorit.

2. Me procedimin metodik të punimit të këngës sipas partiturës me nota, punohet kënga e re. Meqenëse pjesa e Don Xhovanit në tekstin mësimor është e shkruar në origjinal, gjegjësisht në çelësin bas, mësuesi duhet që më parë ta shkruajë në tabelë atë pjesë në çelësin e violinës, me qëllim që të mund të fillojë punimin e këngës sipas partiturës me nota.

3. Pas mësimit të këngës, mësuesi/ja do t’i ndajë nxënësit në grupe djemsh dhe grupe vajzash. Djemtë do të këndojnë tekstin e adaptuar nga pjesa e Don Zhuanit, ndërsa vajzat do të këndojnë pjesën "Zerlinat".

4. Nxënësit/et ekzekutojnë duetin me ndihmën e mësuesit/es (mësuesi/ja tregon me dorë debutimin e çdo grupi veçmas, ekzekuton në piano përcjelljen harmonike të shkruar në tekstin mësimor. Mësuesja mund të nxitë nxënësit që ta ekzekutojnë këtë duet me çifte (nga një djalë dhe nga një vajzë).

5. Mësuesi/ja do të kërkojë nga nxënësit/et që vetë t’i përfytyrojnë lëvizjet dhe mimikën gjatë këndimit të duetit në përputhje me tekstin letrar.

6. Dëgjohet në CD-ë dueti “*Atje do ma japësh dorën*” dhe pyeten nxënësit/et se cili zë burri ose gruaja merr pjesë në ekzekutim. Kërkon prej tyre që ta krahasojnë me arien “Mbretëresha e natës”, të cilën e kanë dëgjuar në pjesën hyrëse të orës dhe të thonë ngjashmëritë dhe dallimet.

Ludvig van Bethoven

1. Fitimi i njohurive për jetën dhe veprimtarinë e L. van Bethovenit

Dëgjimi i muzikës:

1. L. van Bethoven – *Sonata e Hënës* në c-mol, nr. 14., koha I, fragment
2. L. van Bethoven – *Simfonia në c- mol, nr. 5, koha I*, fragment
2. L. van Bethoven – *Simfonia u c-molu, br.5, I stav*, odlomak

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi analitik i muzikës së L. van Bethovenit dhe njohja me krijimtarinë e tij.
3. formimi i grupeve

1. Në pjesën hyrëse të orës të dëgjohet një fragment nga koha I e *Sonatës së Hënës* dhe kërkon nga nxënësit të përshkruajnë karakteristikat e melodisë (e ëmbël, ëndërruese). Pas kësaj bisedon me nxënësit/et për karakterin e kompozimit (i qetë, meditativ, himnizues). Pastaj kërkon të dallojnë se me cilat instrumente ekzekutohet kompozimi. Në tabelë shkruan emrin e kompozitorit, periudhën kur ka jetuar dhe emërtimin e kompozimit.

2. Dëgjohet përsëri fragmenti nga koha I e *Sonatës së Hënës*, kërkon nga nxënësit/et ta përshkruajnë atmosferën që kanë përjetuar pas dëgjimit. Pastaj u flitet si është krijuar sonata (Bethoveni ia ka kushtuar nxënësës Xhulieta Guiçardi). Pas kësaj nxënësit/et do të informohen nga Teksti mësimor me jetën dhe krijimtarinë e L. van Bethovenit

Dëgjojnë fragmentin e Simfonisë nr. 5, në c-mol dhe kërkohet nga nxënësit/et që në bazë të njohurive të arritura të thonë se për cilën formë është fjala dhe për çfarë orkestre (grupi) është shkruar. Kërkon që të trokasin motivin karakteristik me të cilin fillon simfonia. Pastaj u tregon anekdotën mbi krijimin e motivit për këtë vepër të dëgjuar. Gjithashtu u duhet treguar se Bethoveni ka thënë për motivin karakteristik “ashtu fati godet në derë”, ndaj shpesh kjo simfoni emërtohet edhe “*E fatit*”. Dëgjohet përsëri fragmenti dhe kërkohet nga nxënësit të përshkruajnë përjetimin e vet pas dëgjimit të fragmentit të simfonisë. Mësuesi/ja kërkon më pas që nxënëset/et të përshkruajnë karakterin e temës I (ritmike, luftarake) dhe temës II (lirike, melodike). Nxënësit/et në shembullin e kësaj pjese muzikore njihen me pamjen e partiturës, duke shfrytëzuar tekstin me nota nga libri.

3. I ndan nxënësit në disa grupe. Grupi i parë duhet të shqyrtojë të dhënat për Hajdenin, grupi i dytë për Moxartin, i treti për Bethovenin, ndërsa grupi i katërt të krahasojë të tre kompozitorët. Të kihet kujdes që grupet, të cilat në njësitë mësimore të mëparshme kanë shqyrtuar të dhënat për një kompozitor, (p.sh. për Moxartin), kësaj radhe shqyrtojnë të dhënat për kompozitorin e dytë (p.sh. Hajdenin ose Bethovenin). Përfaqësuesit e grupeve shprehin njohuritë që kanë fituar, duke lënë hapësirë, me qëllim që grupet e tjera të mund të plotësojnë atë që, sipas mendimit të tyre, nuk është thënë.

Pamja e tabelës:

L. van Bethoven, kompozitor gjerman, përfaqësues i klasicizmit vjenez në kalimin nga shekulli i 18-të në shekullin e 19-të

- Sonata e Hënës në cis-mol, nr. 14;
- Simfonia në c-mol, nr. 5;
- krijimtaria: simfonitë, sonatat, kuartetet e harqeve dhe vepra të tjera të muzikës së dhomës.



L. van Bethoven: Odja e gëzimit, nga simfonia nr. 9, në d-mol

Qëllimi i orës mësimore:

Mësimi i këngës sipas partiturës me nota

Dëgjimi i muzikës:

1. L. van Bethoven – *Simfonia nr. 5, koha I*, fragment
2. L. van Bethoven – *Odja e gëzimit* nga Simfonia nr. 9, në d-mol

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. punimi i këngës “Odja e gëzimit” sipas partiturës me nota
3. dëgjimi i muzikës
4. modelimi i shoqërimit ritmik

1. Dëgjohet fragmenti nga koha I e Simfonisë nr. 5 , në c-mol dhe kërkohet nga nxënësit që të njohin kompozimin, meqenëse e kanë dëgjuar në orën kushtuar Ludvig van Bethovenit. Kërkon prej tyre të thonë se nga cila simfoni është fragmenti i kohës që kanë dëgjuar, të tregojnë karakteristikat e këtij kompozimi (karakterin, gjendjen shpirtërore, atmosferën) dhe emrin e kompozitorit. Mësuesi pastaj do t’u bëjë të ditur mësimin e këngës së re sipas partiturës me nota dhe shkruan në tabelë emërtimin e kompozimit dhe emrin e kompozitorit.

2. Mësohet kënga e re sipas procedimit metodik të punimit të këngës me nota.

3. Dëgjohet nga CD-ja “*Odja e gëzimit*” dhe pyet nxënësit/et se kush merr pjesë në këtë ekzekutim (solisti, kori dhe orkestra). Kërkon prej tyre që karakterin e “Odes së gëzimit” ta krahasojnë me kohën I të Simfonisë nr. 5, në c-mol, të cilën e kanë dëgjuar në pjesën hyrëse të orës dhe të thonë ngjashmëritë dhe dallimet.

4. Mësuesi/ja e ndan klasën në disa grupe, me detyrën që të modelojnë përcjelljen ritmike të “Odes së gëzimit”. Kur nxënësit/et të mendojnë shoqërimit ritmik, marrin pjesë në ekzekutimin e përbashkët me CD-në. Gjatë modelimit të shoqërimit ritmik, mësuesi/ja mund të ndërhyjë dhe të orientojë nxënësit/et.

MUZIKA E ROMANTIZMIT

Karakteristikat e përgjithshme të muzikës në kohën e romantizmit

Qëllimet e orës mësimore:

1. Fitimi i njohurive për epokën e romantizmit
2. Fitimi i njohurive për karakteristikat e muzikës së romantizmit

Dëgjimi i muzikës:

1. F. Shubert - *Ave Maria*
2. F. Mendelson – *Koncert për violinë dhe orkestër në e- mol* (fragment, koha I)

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi analitik dhe me përjetim, bisedë rreth kompozimit të dëgjuar të F. Shubertit
3. dëgjim analitik dhe bisedë rreth kompozimit të dëgjuar të F. Mendelsonit
4. formimi i grupeve dhe raportimi

1. Në pjesën hyrëse të orës dëgjohej kompozimi "Ave Maria" i Shubertit, duke mos u thënë nxënësve/eve emrin e kompozitorit dhe emërtimin e kompozimit. Nxënësit/et duhet që, duke dëgjuar me vëmendje, të dallojnë karakteristikat e muzikës, t'i përshkruajnë, të shprehin përjetimet e veta, pas të cilave mësuesi i njofton se për cilën epokë është fjala.

2. Dëgjojnë përsëri fragmentin e kompozimit të Shubertit "Ave Maria". Pyet nxënësit/et që të përshkruajnë disponimin dhe karakterin e kompozimit, si edhe çfarë është e re në raport me muzikën e klasicizmit. Kërkon nga nxënësit/et që të përshkruajnë atmosferën që krijon ajo. Nxënësit/et njihen nga Teksti mësimor me rrethanat historiko-shoqërore të shfaqjes së këtij drejtimi, si edhe karakteristikat e muzikës së romantizmit (melodi më e zhvilluar, përdorimi i elementeve folklorike, orkestrim më i kompletuar).

3. Dëgjojnë një fragment nga koha I e *Koncertit për violinë dhe orkestër* në e-mol të Mendelsonit me detyrën që të njohin instrumentin (violinën) dhe të përshkruajnë ngjyrën e zërit të saj (i kulluar, i lartë). Kërkon nga nxënësit/et që të përshkruajnë karakterin e kompozimit, melodinë, tempin dhe dinamikën, si edhe përjetimin që nxit ai tek ata. Shkruan në tabelë emrin e kompozitorit dhe emërtimin e kompozimit.

Përmes dëgjimit të fragmentit nga *Koncerti në e-mol* të Mendelsonit, mësuesi/ja duhet që në pjesën kur debuton orkestra, të bëjë që nxënësit/et të vërejnë se si madhësia e orkestrës në kohën e romantizmit ka qenë ndryshe. Nxënësit duhet të vinë tek përfundimi se orkestra është zgjeruar me instrumente të reja. Krahas kësaj duhet treguar një orkestër e tillë me një fotografi muri, nga



ku nxënësit/et do të dallojnë këto instrumente dhe do të vërejnë edhe vendin e tyre në orkestër. Pas kësaj nxënësit/et do të informohen vetë nga teksti mësimor për karakteristikat e romantizmit muzikor (zhvillimi i orkestrës, operës, lëvizjeve kombëtare, muzikës programore, kompozitorëve më të rëndësishëm).

4. I ndan nxënësit në disa grupe. Dy-tri grupe duhet të shqyrtojnë të dhënat mbi epokën e muzikës në klasicizëm, ndërsa dy-tri të tjera mbi epokën e muzikës së romantizmit. Grupet që janë marrë me muzikën e klasicizmit i bëjnë pyetje njëri-tjetrit, si edhe grupet që janë marrë me romantizmin. Përgjigjet e sakta dhe të plota fitojnë pikë të caktuara dhe në fund shpallet grupi më i mirë.

Pamja e tabelës:

Romantizmi

- Shekulli i 19-të

F. Mendelson

- Koncert për violinë dhe orkestër në e-mol

Muzika e romantizmit

Karakteristikat e përgjithshme:

- melodia më e zhvilluar
- përdorimi i elementeve folklorike
- orkestrimi më i kompletuar

Përbërjet instrumentale:

- orkestra; e zgjeruar me instrumente të reja: kontrafagot, bas-klarinetë, corni anglez, tuba, flauti piccolo, daulle e madhe dhe e vogël, ksilofon, celestë, triangel dhe harpë; është rritur numri i instrumenteve që deri atëherë kanë qenë në përbërje të orkestrës klasike: violinës, violës, violonçelit, kornës, trumbetës dhe timpanit.

Muzika vokalo-instrumentale:

- opera

FORMAT MUZIKORE TË ROMANTIZMIT

Qëllimi i orës mësimore:

Fitimi i njohurive për format e reja muzikore: miniatura pianistike dhe kënga solo

Dëgjimi i muzikës:

F. Shubert: - Ave Maria

R. Shuman: - Miniatura pianistike “*Kalorësi i egër*”

F. Shubert: - Kënga solo “*Gogoli*”

Hapat kryesorë

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi analitik dhe me përjetim i miniaturës pianistike
3. dëgjim analitik dhe me përjetim i këngës solo
4. të shprehurit në mënyrë figurative i përjetimit muzikor

1. Në pjesën hyrëse të orës duhet të dëgjohet kompozimi “Ave Maria” të cilin nxënësit/et e kanë dëgjuar në orën e mëparshme dhe thonë karakteristikat e epokës së romantizmit. Mësuesi/ja i nxit të konstatojnë se si epoka e re sjell edhe forma të reja, por edhe i ruan ato që janë zhvilluar në kohën e klasicizmit (sonata, koncerti, simfonia).

2. Dëgjohet miniatura pianistike “*Kalorësi i egër*” e R. Shumanit. Kur nxënësit/et të përgjigjen në pyetjet se për cilin instrument është fjala dhe përshkruajnë karakterin e kompozimit, mësuesi i njofton se për cilën formë është fjala (miniatura pianistike). Nxënësit/et informohen në Tekstin mësimor për të gjitha karakteristikat e kësaj forme. Pas kësaj, kërkon prej tyre që të përshkruajnë se çfarë përjetimi zgjon ajo tek ta dhe në çfarë i asocion. Pastaj shkruan në tabelë R. Shuman: *Kalorësi i egër*.

3. Lëshon këngën “*Gogoli*” të F. Shubertit dhe kërkon nga nxënësit që të njohin se cili zë ekzekuton kompozimin e dëgjuar. Bisedon për karakterin e këngës solo të dëgjuar (trishtuese), si edhe përjetimin që ajo ka zgjuar tek ta; në çfarë i ka asocuar.

Para se të dëgjohet përsëri, kërkon nga nxënësit të përqendrojnë vëmendjen në linjën melodike të solistit (më shumë e folur se e kënduar) dhe vërejnë rrjedhën e pjesës pianistike (virtuoze). Lëshon përsëri këngën solo me detyrën që të përshkruajnë raportin mes zërit dhe instrumentit. Pastaj i njofton nxënësit/et se është fjala për kryeveprën, baladën e njohur “*Gogoli*” me vargje të Gëtes. Shkruan në tabelë emrin e kompozitorit dhe emërtimin e kompozimit. Pastaj mësuesi do të njohë nxënësit me tekstin e baladës. Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit/et, që gjatë kohës së dëgjimit të këngës solo “*Gogoli*” të përcjellin partiturën me nota të fragmentit që ndodhet në Libër.

Nxënësi do të informohen vetë në Tekstin mësimor për format e tjera karakteristike të muzikës së romantizmit (poema simfonike, opera, opereta, baleti).



4. Kërkon nga nxënësit/et që përjetimin e vet për kompozimet e dëgjuara ta tregojnë në mënyrë figurative (me pikturë, vizatim etj.). Të ndahen punimet më të mira dhe të kërkojë nga nxënësit/et që të tjerëve t’ua arsyetojnë qëndrimin e tyre për miniaturën pianistike “Kalorësi i egër” (si e kanë përjetuar kalorësin e egër) dhe këngën solo “Gogoli” (të përshkruajnë si e kanë përjetuar gogolin).

Pamja e tabelës:

miniatura pianistike – formë e shkurtër muzikore e shkruar për piano

R. Shuman

- “Kalorësi i egër” , miniaturë pianistike

Kënga solo; formë muzikore e shkruar për zërin krahas përcjelljes pianistike

F. Shubert

- “Gogoli” , këngë solo

PËRFAQËSUESIT E ROMANTIZMIT NË MUZIKË NË GJYSMËN E PARË TË SHEKULLIT TË 19-TË.

Franc Shubert

Qëllimi i orës mësimore:

Fitimi i njohurive mbi jetën dhe krijimtarinë e F. Shubertit

Dëgjimi i muzikës:

1. F. Shubert: Kënga solo “*Gogoli*”

2. F. Shubert: Simfonia në h-mol, nr. 8, “*E pambaruar*”, koha I, fragment

3.F. Shubert: *Momenti muzikor* në f-mol, op. 94, nr. 3

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi analitik dhe me përjetim i muzikës së F. Shubertit dhe njohja me jetën dhe krijimtarinë e tij
3. formimi i grupeve dhe raportimi

1. Ora fillon me dëgjimin e këngës solo “*Gogoli*” të F. Shubertit. Nxënësit/et duhet të thonë se për cilin kompozim është fjala, të tregojnë karakteristikat e kësaj forme, për të cilën kanë mësuar në orën e mëparshme dhe të kujtojnë emrin e kompozitorit. Shkruhet në tabelë emri i kompozitorit, emërtimi i kompozimit dhe shekulli në të cilin ka jetuar F. Shuberti.

2. Pas pjesës hyrëse të dëgjohej koha I e Simfonisë në h-mol “Të pambaruarat”. Kërkon nga nxënësit të thonë se për cilën formë është fjala (simfonia). Lëshohet fragmenti edhe një herë dhe u kërkon nxënësve/eve të përshkruajnë përjetimin e vet për kompozimin.

Kërkon nga nxënësit/et që të përshkruajnë karakterin e fragmentit të dëgjuar të *Simfonisë së pambaruar* (melankolik, i trishtuar). U bëhet e ditur se simfonia është e kompozuar në dy kohë, për ç’arsye e ka fituar edhe këtë emër “*E pambaruara*”. Nxënësit/et informohen vetë nga Teksti mësimor për jetën dhe krijimtarinë e F. Shubertit. Dëgjohej edhe një herë fragmenti dhe udhëzohen nxënësit/et që të njohin temën I dhe II të formës së sonatës dhe kërkon prej tyre të përshkruajnë karakterin e tyre (tema I është melankolike, tema II e kënduar). Mësuesi/ja u bën të ditur nxënësve/eve që gjatë dëgjimit të kompozimit, mund të përcjellin tekstin me nota nga libri, ku janë treguar hyrja, tema I dhe II e *Simfonisë së pambaruar*.

3. Pas kësaj lëshon *Momenti muzikor* në f-mol dhe kërkon nga nxënësit/et që të njohin formën (miniatura pianistike). Shkruan në tabelë emërtimin e kompozimit. Nxënësit/et duhet të thonë karakteristikat e kësaj forme, të cilat i kanë mësuar në orën e mëparshme. Nxënësit/et duhet të përshkruajnë përjetimin e vet të këtij kompozimi dhe të përshkruajnë karakterin e tij (entuziast, i vrullshëm). Nxënësit/et informohen për jetën dhe krijimtarinë e Shubertit nga Teksti mësimor.

4. Të formohen disa grupe nxënësish/esh me detyrën që grupi i parë të merret me kuriozitetet nga jeta e Shubertit, grupi i dytë me krijimtarinë e tij, grupi i tretë me jetën e tij, ndërsa grupi i katërt me përshkrimin e kompozimeve të Shubertit, të cilat i kanë dëgjuar.

Pamja e tabelës:

F. Shubert, kompozitor austriak, përfaqësues i romantizmit të hershëm, gjysma e parë e shekullit të 19-të.

- Simfonia në h-mol, nr. 8, “E pambaruara”
- Momenti muzikor në f-mol, op. 94, nr. 3
- krijimtaria: simfonitë, këngët solo, kuarteti i harqeve, kompozimet pianistike.



Feliks Mendelson - Bartoldi

Qëllimi i orës mësimore:

Fitimi i njohurive mbi jetën dhe krijimtarinë e F. Mendelsonit

Dëgjimi i muzikës:

1. F. Mendelson: Koncert për violinë dhe orkestër në e-mol, koha I, fragment
2. F. Mendelson: Simfonia në A-dur, nr. 4., *Italiane*, koha I, fragment
3. F. Mendelson: Uvertura për “*Ëndrra e një natë vere*”

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi analitik dhe me përjetim i muzikës së Mendelsonit dhe njohja me jetën dhe krijimtarinë e tij.
3. formimi i grupeve dhe raportimet

1. Në pjesën hyrëse të orës dëgjohet fragmenti i kohës I të *Koncertit për violinë dhe orkestër në e-mol* të F. Mendelsonit, të cilin nxënësit e kanë dëgjuar kur kanë mësuar karakteristikat e përgjithshme të romantizmit. Nxënësit/et duhet të njohin romantizmin, të thonë karakteristikat e tij dhe të kujtojnë emrin e kompozitorit. Të shkruhet në tabelë emri i kompozitorit.

2. Pas kësaj dëgjojnë fragmentin e kohës I të Simfonisë në A-dur – *Italiane* të F. Mendelsonit. Kërkon nga nxënësit të njohin formën e fragmentit të kompozimit të dëgjuar (simfoni) dhe pastaj mësuesi i njeh me emërtimin e kompozimit dhe e shkruan poshtë emrit të kompozitorit. Kërkon nga nxënësit të përshkruajnë sesi e përjetojnë këtë muzikë (e lehtë, e gëzueshme, e ngrohtë, argëtuese).

Pastaj mësuesi/esja i fut nxënësit që nga emërtimi i simfonisë (*Italiane*) të nxjerrin vetë si është krijuar ky kompozim (pas qëndrimit të Mendelsonit në Itali, ku e ka frymëzuar klima e ngrohtë mesdhetare, deti dhe muzika folklorike italiane. Nxënësit informohen vetë nga Teksti mësimor për jetën dhe krijimtarinë e këtij kompozitori.

Pas kësaj, dëgjojnë nga CD-ja uverturën “*Ëndrra e një natë vere*” dhe kërkon prej tyre të bëjnë dallimin (sipas karakterit) mes këtij kompozimi dhe atij të mëparshmit. Kërkon nga nxënësit/et që të përshkruajnë përjetimin e vet gjatë dëgjimit të këtij kompozimi. I informon se është fjala për formën orkestrale që paraqet muzikën hyrëse për veprën skenike të Shekspirit “*Ëndrra e një natë vere*”, të cilën Mendelsoni e ka kompozuar kur ka pasur vetëm 17 vjet. Gjithashtu mësuesi duhet t’u thotë nxënësve se është fjala për uverturën, formë të cilën nxënësit/et e kanë mësuar që në vitin e kaluar. Përmes bisedës përkujton me nxënësit këtë formë (kompozimi është shkruar për orkestër simfonike, në të cilën nuk ekziston ndarja në kohë dhe e cila mund të paraqesë pjesën hyrëse të një forme muzikore-skenike më të madhe - operës, ose bile edhe një kompozim të pavarur). Shkruan në tabelë emërtimin e kompozimit. Nxënësit/et informohen vetë nga Teksti mësimor për jetën dhe krijimtarinë e Mendelsonit.

3. I ndan nxënësit/et në katër grupe. Në kuadër të grupit të parë nxënësit bisedojnë për përshtypjet që kanë ngjallur tek ata dëgjimi i *Simfonisë italiane* (shkëmbejnë mendime në kuadër të të cilave duhet të vinë në konstatime të përbashkëta). Në kuadër të grupit të dytë, nxënësit/et bisedojnë për uverturën “Ëndrra e një natë vere”; në kuadër të grupit të tretë nxënësit/et bisedojnë për Koncertin për violinë dhe orkestër në e-mol, ndërsa në kuadër të grupit të katërt, nxënësit/et krahasojnë kompozimet e dëgjuara të Mendelsonit dhe Shubertit. Pas kësaj, një përfaqësues nga grupi paraqet qëndrimet, përshtypjet dhe mendimet për kompozimet e dëgjuara.

Pamja e tabelës:

F. Mendelson, kompozitor gjerman, përfaqësues i romantizmit të hershëm, gjysma e parë e shekullit të 19-të

- Simfonia në A-dur, nr. 4, *Italiane*
- Uvertura për “Ëndrra e një nate vere”
- krijimtaria: simfonitë, kompozimet pianistike, uverturat, koncertet

Robert Schuman

Qëllimi i orës mësimore:

Fitimi i njohurive për jetën dhe krijimtarinë e R. Shumanit

Dëgjimi i muzikës:

1. R. Schuman: Miniatura pianistike “*Kalorësi i egër*”
2. R. Schuman: *Simfonia e Rinit* në E-dur, nr. 3, koha I, fragment
3. R. Schuman: Koncert për piano dhe orkestër në a-mol, op. 54, koha I, fragment

Hapat kryesorë

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi me përjetim i muzikës së Shumanit dhe njohja me jetën dhe krijimtarinë e tij
3. të shprehurit figurativ individual dhe argumentimi i paraqitjes figurative

1. Në pjesën hyrëse të orës dëgjohej miniatura pianistike “*Kalorësi i egër*”, të cilën nxënësit/et e kanë dëgjuar kur kanë mësuar për format e romantizmit muzikor. Nxënësit/et thonë formën e kompozimit, karakteristikat e formës, emërtimin e kompozimit dhe emrin e kompozitorit që e ka kompozuar. Mësuesi shkruan në tabelë emrin e kompozitorit.

2. Pas kësaj, dëgjohej nga Shumani fragmenti nga *Simfonia e Rinit*, koha I, në Es-dur, nr.3. Kërkon nga nxënësit të gjejnë formën e fragmentit të dëgjuar dhe pastaj të përshkruajnë përshtypjet e veta pas dëgjimit të fragmentit nga simfonia. Pastaj shkruhet në tabelë emërtimi i kompozimit.



Nxënësit informohen vetë për jetën dhe krijimtarinë e R. Shumanit nga Teksti mësimor. Kuptojnë se kjo simfoni e tij iëshhtë kushtuar lumit të Rinit, një himn për natyrën dhe pejzazhet e Rinit. Mësuesi/ja i informon nxënësit/et se titulli i simfonisë na fut në karakterin e saj programor.

Përsëri dëgjohe fragmenti dhe nga nxënësit/et kërkohet të njohin temën I dhe II të kësaj kohe.

Dëgjohe fragmenti i kohës I të *Koncertit për piano dhe orkestër në a-mol*, nr. 54. Pas dëgjimit të parë, nxënësit duhet të njohin instrumentet që marrin pjesë në ekzekutimin e kësaj pjese (piano me orkestër). Kërkohet nga nxënësit të thonë se për cilën formë instrumentale është fjala (koncert për piano dhe orkestër). I fut nxënësit/et që të tregojnë se cilat janë karakteristikat e koncertit (numri i kohëve, ndërtimi, tempi). Kërkon nga nxënësit/et që, pas njohjes së formës, të japin përshkrimin e përjetimit të vet për fragmentin e dëgjuar nga koncerti, koha I.

3. Mbi bazën e dëgjimit të përsëritur të fragmentit nga *Simfonia e Rinit*, koha I, kërkohet nga nxënësit/et të shprehin përshtypjet e veta figurative për të. Punimet më të mira, sipas vlerësimit të nxënësave/eve, autorët i argumentojnë para paraleles.

Pamja e tabelës:

R. Shuman, kompozitor gjerman, përfaqësues i romantizmit të hershëm, gjysma e parë e shekullit të 19-të.

- krijimtaria: simfonitë, miniaturat pianistike, format e muzikës së dhomës, koncertet, këngët solo
- *Simfonia e Rinit* në E-dur, nr. 3
- Koncert për piano dhe orkestër në a-mol, op. 54

Robert Shuman: *Kënga e ushtarit*

Qëllimi i orës mësimore:

Mësimi i këngës së re

Dëgjimi i muzikës:

R. Shuman - miniatura pianistike “*Kalorësi i egër*”

R. Shuman - *Kënga e ushtarit*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. punimi i këngës “*Kënga e ushtarit*” sipas partiturës me nota
3. dëgjimi i muzikës
4. formimi i grupeve dhe ekzekutimi

1. Në pjesën hyrëse të orës dëgjohe miniatura pianistike “*Kalorësi i egër*” dhe kërkohet nga nxënësit të njohin emërtimin e kompozimit dhe emrin e kompozitorit, përcaktimin e formës së saj dhe të përshkruajnë karakterin e saj. U bën të ditur mësimin e këngës së re sipas partiturës me nota dhe shkruan në tabelë emërtimin e kompozimit dhe emrin e kompozitorit.

2. Me procedimin e njohur metodik punohet kënga e re sipas partiturës me nota.

3. Dëgjohet nga CD-ja “*Kënga e ushtarit*” për zërin dhe pianon. Kërkon nga nxënësit të përshkruajnë karakterin e saj, gjendjen shpirtërore dhe atmosferën që përshkruan.

4. Pas kësaj i ndan nxënësit/et në shumë grupe. Njërin grup e bëjnë nxënësit/et që kanë për detyrë ta këndojnë këngën e mësuar; grupin e dytë e bëjnë nxënësit/et që duhet të ekzekutojnë përcjelljen instrumentale me goditëse: çinel; të tretin e bëjnë nxënësit që duhet ta bëjnë përcjelljen instrumentale me triangël; grupin e katërt e bëjnë nxënësit që duhet ta ekzekutojnë përcjelljen instrumentale me daulle etj., në përshtatje me mjetet instrumentale që ka shkolla në dispozicion. Nxënësit që u bien veglave me goditje ushtrojnë pjesët e veta, pastaj së bashku ushtrojnë ekzekutimin në veglat me goditje. Në fund debutojnë në ekzekutimin vokalo-instrumental nën drejtimin e mësuesit/es.

Frederik Shopen

Qëllimi i orës mësimore:

Fitimi i njohurive mbi jetën dhe krijimtarinë e F. Shopenit

Dëgjimi i muzikës:

1. F. Shopen: *Etyd revolucionar në c-mol*
2. F. Shopen: *Vals në D-dur*
3. F. Shopen: *Prelud në e-mol*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi me përjetim i muzikës së Shopenit dhe njohja me jetën dhe krijimtarinë e tij.
3. formimi i grupeve dhe raportimet

1. Në pjesën hyrëse të orës lëshohet nga CD-ja “*Etydi revolucionar*” i Shopenit. Pas dëgjimit bisedohet për karakterin, atmosferën dhe përshtypjet, ndërsa më pas mësuesi/ja njofton emrin e kompozitorit dhe emërtimin e kompozimit.

2. Dëgjohet përsëri *Etydi revolucionar* dhe pyet nxënësit së me cilin instrument ekzekutohet (piano). Informon nxënësit/et se për cilën formë është fjala (etyd) dhe i njeh nxënësit/et me rrethanat në të cilat është krijuar kjo vepër. Pas kësaj, nga Teksti mësimor, nxënësit/et informohen vetë për jetën dhe krijimtarinë e Shopenit.

Dëgjojnë *Valsin në D-dur* dhe i fut nxënësit të vërejnë mbi bazën e njohurive të fituara, se për cilën formë është fjala. I informon se valsit me Shopenin ka përjetuar transformim dhe u tregon se çfarë është transformuar. Pas kësaj, nxënësit/et informohen vetë për formën dhe origjinën e valsit në Tekstin mësimor. Shkruhet në tabelë emërtimi i kompozimit.



Dëgjohet *Preludi në e-mol* dhe kërkohet nga nxënësit të përshkruajnë atmosferën dhe përjetimin pas dëgjimit të kompozimit. Kërkon nga nxënësit të përshkruajnë karakterin e preludit (i qetë, i kënduar). Shkruan në tabelë emërtimin e kompozimit. Pas kësaj, mësuesi/ja i fut nxënësit të kujtojnë se në cilën epokë përmendet emërtimi prelud (barok) dhe e krahasojnë me preludin e shekullit të 19-të. I informon nxënësit se është fjala për formën muzikore, të cilën Chopeni gjithashtu e ka transformuar dhe shpjegon se si është manifestuar ai.

3. I ndan nxënësit/et në katër grupe. Në kuadër të grupit të parë, nxënësit/et bisedojnë për përshtypjet që ka ngjallur tek ata dëgjimi i *Etydit revolucionar* (shkëmbejnë mendime në kuadër të cilave duhet të vinë deri në konstatime të përbashkëta). Në kuadër të grupit të dytë nxënësit bisedojnë për valsin e Chopenit në D-dur. Në kuadër të grupit të tretë nxënësit bisedojnë për *Preludin në e-mol*, ndërsa në kuadrin e grupit të katërt, nxënësit/et krahasojnë kompozimet e Chopenit, të cilat i kanë dëgjuar. Pas kësaj, një përfaqësues nga çdo grup paraqet qëndrimet, përshtypjet dhe mendimet e grupit.

Pamja e tabelës:

F. Chopen, kompozitor polak i pianos, përfaqësues i romantizmit të hershëm, gjysma e parë e shekullit të 19-të.

- Etydi revolucionar në c-mol
- Vals në D-dur
- Prelud në e-mol

Krijimtaria: valse, prelude, etyde, mazurka, poloneze etj.

MUZIKA PROGRAMORE

Hektor Berlioz

Qëllimet e orës mësimore:

1. Fitimi i njohurive për muzikën programore
2. Fitimi i njohurive për jetën dhe krijimtarinë e Hektor Berliozit

Dëgjimi i muzikës:

1. A. Vivaldi – *Dimri*, koha I
2. L. van Bethoven – *Simfonia pastorale*, koha I, fragment
3. Hektor Berlioz – *Simfonia fantastike*, koha I, fragment

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. njohja me termin “*programore*” dhe rëndësinë e programit në kompozimet e romantizmit.
3. vërejtja dhe dallimi i ciklit simfonik të periudhës së klasicizmit dhe i ciklit simfonik me përmbajtje programore
4. njohja me krijimtarinë e Hektor Berliozit

1. Në pjesën hyrëse të orës nxënësit dëgjojnë një fragment nga koha I “*Dimri*” të A. Vivaldit. Kërkon nga nxënësit të dallojnë elementet e ilustracionit. Njeh nxënësit me kompozimet e përfaqësuesve të epokës tjetër (klasicizmit) në të cilën janë prezente elementet e para të programimit: L. van Bethoven- *Simfonia pastorale* dhe kërkon nga nxënësit që t’i njohin. U thotë nxënësve/eve se çdo kohë në Simfoninë pastorale të Bethovenit ka titullin dhe kërkon prej tyre se në çfarë i asocojnë ata tituj.

2. Dëgjohet koha I (ose një pjesë e kohës I) të *Simfonistë fantastike* të Hektor Berliozit. Bisedohet për përjetimin, atmosferën, formën, dhe pastaj në tabelë shkruhet emri i kompozitorit dhe shekulli kur ka krijuar (Hektor Berlioz, shekulli i 19-të), si edhe emërtimi i kompozimit (*Simfonia fantastike*). Nxënësit informohen për programin nga Teksti mësimor. U tregohet nxënësve se programi është i shtypur me partiturë, me qëllim që dëgjuesit të mund të njiheshin me përmbajtjen e kompozimit.

3. Lëshohet tema –ide fikse nga koha I dhe V dhe kërkohet nga nxënësit/et të japin karakteristikat themelore të temës në ato kohë (melodia, ritmi, zgjedhja e instrumenteve, karakteri). Përsëri dëgjohet tema në kohën I dhe V në përcjellje të partiturës me nota-ide fikse në kohët e përmendura në Tekstin mësimor dhe kërkohet nga nxënësit/et të lidhin zgjedhjen e instrumenteve me ndryshimin e karakterit me programin.

Në tabelë shkruan numrin e kohëve dhe emërtimet e tyre, ndërsa pastaj, duke shfrytëzuar informacionet nga tabela, kërkon nga nxënësit/et të vërejnë ndryshimin mes ciklit simfonik klasik dhe ciklit simfonik të një kompozimi programor (numri i kohëve rritet për arsye të programit).

4. Nxënësit informohen vetë nga Teksti mësimor për rëndësinë e Hektor Berliozit. Diskutojnë me nxënësit rreth përbërjes së orkestrës së Berliozit në shembullin *Simfonistë fantastike* dhe përvojën e tij si dirigjent. Kërkon nga nxënësit që të thonë se cilët dirigjentë njohin.

Pamja e tabelës:

- Muzika programore
Hektor Berlioz, kompozitor francez, shekulli i 19-të
- Simfonia fantastike, pesë kohë:
Koha I - *Ëndërrime dëshirash*
Koha II – *Në vallëzim*
Koha III – *Skena në fushë*
Koha IV – *Rruga drejt trekëmbëshit (gijotinës)*
Koha V – *Ndenja e magjistareve*



Franc List

Qëllimi i orës mësimore:

1. Fitimi i njohurive për zhvillimin e muzikës programore në romantizëm
2. Fitimi i njohurive për formën e re muzikore - poema simfonike
3. Të mësojnë rreth krijimtarisë së Franc Listit

Dëgjimi i muzikës:

1. F. List – Simfonia “*Fausti*”
2. F. List – Poema simfonike “*Prelude*”
3. F. List – *Sonata pianistike h-mol*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës - linja e dytë e zhvillimit të muzikës programore
2. dallimi i ngushtimit të ciklit simfonik
3. njohja me formën e re muzikore - poemën simfonike
4. njohja me kontributin e Listit në muzikën pianistike dhe në ekzekutim.

1. Ora e mësimimit fillon me dëgjimin e pjesës së kohës I nga simfonia “Fausti” dhe kërkon nga nxënësit të dinë se për cilën përbërje është shkruar kjo simfoni. I pyet se si quhet tipi i simfonisë në romantizëm, i cili ka program (simfonia programore).

2. Para dëgjimit të dytë i njeh me temën (“Fausti”). Shkruan në tabelë emrin e kompozitorit, shekullin kur ka jetuar, emërtimin e veprës dhe numrin e kohëve. Kërkon nga nxënësit ta krahasojnë me numrin e kohëve në simfoninë e Berliozit dhe të vërejnë ndryshimin (zvogëlohet numri, vetëm tri kohë, përsëri ndikimi i programit).

3. Dëgjohej një pjesë e poemës simfonike “Preludi” të Listit dhe kërkon nga nxënësit/et të dallojnë ndryshimin në lidhje me simfoninë (kompozim me një kohë). Mësuesi/ja do t’u shpjegojë nxënësve se në romantizëm shfaqet një formë e një gjinie me simfoninë, që quhet poema simfonike. Në tabelë të shkruhet: poema simfonike e shkruar për orkestër, kompozim me një kohë i karakterit programor. Pas dëgjimit të dytë të poemës simfonike “Preludi” nxënësve/eve u tregohet se për programin ka përdorur vjershën me të njëjtin titull të Lamartinit. Kërkon nga nxënësit/et që me fjalët e veta të tregojnë përmbajtjen muzikore të ekzekutuar.

4. Lëshohet fragmenti nga “Sonata në h-mol” e Listit. Nxënësit/et dinë se me cilin instrument ekzekutohet kompozimi. Pas dëgjimit të fragmentit, nxënësit/et do të duhej të dallojnë se ekzekutimi i kompozimit kërkon një teknikë shumë të zhvilluar. Informon nxënësit/et se kompozimi është shkruar në një kohë, si edhe poema simfonike, por pa u mbështetur në përmbajtjen letrare. Kërkon nga nxënësit/et që ta krahasojnë me numrin e kohëve tek sonata e periudhës së klasicizmit dhe romantizmit të hershëm, të cilat i kanë përmendur gjatë vitit mësimor.

Kërkohet nga nxënësit/et, që në bazë të informacioneve nga Teksti mësimor të tregojnë për kontributin e Listit në teknikën pianistike (Listi është krijuesi i shkollës për mësimin e pianos), si edhe terminologjisë muzikore (pas shfaqjes së një koncerti të Listit është vendosur termi “recital”- për koncertin solistik).

Pamja e tabelës

Cikli simfonik i Listit:

- Simfonia “Faust”

- Tri kohë

Koha I: Fausti

Koha II: Margarita

Koha III: Mefistofeli

Poema simfonike:

- kompozim me një kohë me përmbajtje programore i shkruar për orkestër

- Franc List, kompozitor hungarez i gjysmës së dytë të shekullit të 19-të, virtuoz i madh i pianos dhe krijuesi i poemës simfonike.

O, moj vajzë e gëzuar (Oj, vesela veselice)

Qëllimi i orës mësimore:

Mësimi i këngës së re

Dëgjimi i muzikës:

1. *O, moj vajzë e gëzuar*- këngë popullore nga Mali i Zi (ekzekutim vokalo-instrumental)

Hapat kryesorë

1. pjesa hyrëse

2. punimi i këngës “*O, moj vajzë e gëzuar*” sipas partiturës me nota

3. dëgjimi i muzikës

1. Në pjesën hyrëse të orës përsërit njërën nga këngët popullore të mësuara në klasën e mëparshme (*O, vajzë, ku i vole trëndafilat, O çoban, Vajzë e bukur*) dhe kështu i bën nxënësit të këndojnë. Mësuesi/ja duhet të kërkojë nga nxënësit të thonë se cilat janë karakteristikat e këngës popullore të punuar (melodia, ritmi, tempi, karakteri...), pastaj të publikojë këngën e re të muzikës tradicionale “*O moj vajzë e gëzuar*”(Oj, vesela veselice) dhe tregon shkrimin e saj me nota, të shkruar në tabelë ose në një karton. I shtyn nxënësit/et që të nxjerrin përfundimin në bazë të tekstit që analizohet se është fjala për një këngë popullore dasme.



2. Me procedimin metodik të mësimit të këngës sipas partiturës me nota, punohet kënga e re.
3. Pas ekzekutimit nga nxënësit/et, lëshohet regjistrimi i zërit nga CD-ja, me qëllim që nxënësit/et të fitojnë përshtypjen e përgjithshme tingullore të këngës tradicionale. Komentohet se si tingëllon kënga, nëse atmosfera e saj i përgjigjet zakonit (dasmës) përshkruajnë përjetimin e vet pas dëgjimit të këngës.

OPERA NË KOHËN E ROMANTIZMIT

Zhvillimi i operës italiane

Xhoakino Rosini, Xhuzepe Verdi

Qëllimet e orës mësimore:

1. Fitimi i njohurive mbi zhvillimin e operës në Itali në shekullin e 19-të
2. Të njohin krijimtarinë operistike të kompozitorëve Xhoakino Rosini dhe Xhuzepe Verdi

Dëgjimi i muzikës:

1. Xh. Rosini: Berberi i Seviljes, aria “Unë jam kujdestari pa interes i qytetit”
2. Xh. Verdi: Opera “Nabuko”, kori i hebrenjve, “Fluturo o ëndërr në krahët e artë”, kor i përzier
3. Xh. Verdi: Opera “Traviata”, Kënga e verës
4. Xh. Verdi: Opera “Rigoletto”, Gruaja të gënjen

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. njohja me krijimtarinë e Xh. Rosinit dhe bashkëkohësve të tij
3. njohja me krijimtarinë e Xh. Verdit
4. punimi i këngës

1. Pas dëgjimit të aries nga opera e Rosinit “Berberi i Seviljes” - *Unë jam kujdestari painteres i qytetit*”, kërkon nga nxënësit/et që të njohin ekzekutuesit dhe formën, të bisedojnë për karakterin e aries, të përshkruajnë gjendjen shpirtërore që ngjall tek ata muzika, ndërsa më pas, në tabelë shkruajnë emrin e kompozitorit, shekullin në të cilin ka krijuar dhe emërtimin e veprës. Me pyetjet për operën si formë muzikore, për pjesët përmbajtësore të saj (ariet, recitativi, duetet, ansamblet, pjesët korale dhe orkestrale) të përsëritë lëndën mbi zhvillimin e operës në epokat e mëparshme.

2. Udhëzon nxënësit/et që duke dëgjuar arien “Unë jam kujdestari painteres i qytetit” të përcjellin tekstin me nota nga Teksti mësimor. Pas dëgjimit të aries kërkon nga nxënësit/et që, në bazë të

mënyrës së modelimit të mjeteve muzikore (melodia, ritmi, trajtimi vokal i pjesës, roli i orkestrës) të përcaktojë llojin e operës (opera komike) dhe pastaj të lexojnë libretin dhe thonë personazhet kryesore të operës *”Berberi i Seviljes”*.

Kërkon nga nxënësit që në bazë të të dhënave nga Teksti mësimor të informohen mbi jetën dhe krijimtarinë e Xhoakino Rosinit.

3. Pas dëgjimit të pjesës korale *”Fluturo, o ëndërr në krahët e artë”* nga opera *“Nabuko”* e Verdit, bisedon për ata që e ekzekutojnë dhe për përjetimin e muzikës që kanë dëgjuar dhe më pas shkruan emrin e kompozitorit, shekullin kur ka jetuar dhe krijuar dhe emërtimin e operës. Pastaj kërkon nga nxënësit/et që të krahasojnë këtë shembull me atë që e kanë dëgjuar më parë (Rosini: *Unë jam kujdestari pa interes i qytetit*).

I udhëzon nxënësit/et që, duke përdorur Tekstin mësimor, të informohen për jetën dhe krijimtarinë e Verdit.

Pas dëgjimit dhe shikimit të pjesës *”Kënga e verës”* nga opera *”Traviata”*, bisedohet për përjetimin e muzikës dhe pastaj shkruhet në tabelë emërtimi i operës. Kërkon nga nxënësit/et që në bazë të të dhënave nga Teksti mësimor, të dallojnë se si, sipas tematikës, skenografisë dhe kostumografisë, opera në fjalë dallohet nga operat e tjera të Verdit.

I informon nxënësit se libreti është krijuar sipas veprës së shkrimtarit të dëgjuar Aleksandër Dyma (biri) *“Zonja me kamelië”*. Dëgjojnë përsëri arien dhe kërkon nga nxënësit/et që të përcaktojnë se për cilin zë është shkruar dhe si është trajtimi vokal i pjesës. I pyet nxënësit/et, nëse mund të japin mendimin e vet për muzikën e Verdit, në bazë të shembullit të dëgjuar.

Pas dëgjimit të aries *“Gruaja është gënjeshtare”* nga opera *“Rigoletto”* e Verdit kërkon nga nxënësit/et të shprehin përjetimin e vet për muzikën, shkruan në tabelë emrin e operës dhe e krahason me arien nga opera e Rosinit, të cilën e kanë dëgjuar në fillim të orës.

4. Punohet një pjesë e aries *”Gruaja është gënjeshtare”* të Verdit, sipas procedimit metodik dhe më pas të këndohet.

Vërejtje: Ariet *“Kënga e verës”* nga opera *“Traviata”* dhe *“Gruaja është gënjeshtare”* nga opera *“Rigoletto”* të Xh. Verdit, mund të shikohen në videokasetën Opera 1 dhe 2, të cilën e ka përgatitur Mirjana Ivanoviq, si botim i Entit për botimin e librave dhe mjeteve mësimore të Serbisë.

Pamja e tabelës:

Xhoakino Rosini, gjysma e parë e shekullit të 19-të

- Berberi i Seviljes

Xhuzepe Verdi

- Nabuko

- Traviata

- Rigoletto

Vërejtje: Për realizimin e kësaj njësie mësimore mund të planifikohen 2 orë.



Verizmi në operën italiane

Pjetro Maskanji, Ruxhero Leonkavallo, Xhakomo Puçini

Qëllimet e orës mësimore:

1. Fitimi i njohurive mbi zhvillimin e operës veristike në Itali në fund të shekullit të 19-të
2. Të njohin krijimtarinë e kompozitorëve të operës Pjetër Maskanji, Ruxhero Leonkavallo dhe Xhakomo Puçini.

Dëgjimi i muzikës:

1. P. Maskanji: opera “*Kavalerie rustikana*” (intermexo)
2. Xh. Puçini: opera “*Toska*” (*E lucevan le stelle – Dhe yjet kanë ndriçuar*)

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. njohja me krijimtarinë e P. Maskanjit dhe R. Leonkavallos
3. njohja me jetën dhe krijimtarinë e Xhakomo Puçinit
4. formimi i grupeve

1. Lëshohet një fragment nga opera “*Kavaleria rustikana*”. Kërkon nga nxënësit/et që të komentojnë shembullin që kanë dëgjuar dhe të shprehin përjetimin e vet muzikor, pastaj në tabelë shkruhet emri i kompozitorit dhe emërtimi i kompozimit që kanë dëgjuar.

2. Pasi njihen nxënësit/et me libretin e operës, kërkon të krahasojnë dhe të gjejnë tematikën e ngjashme në krijimtarinë e Verdit (*Rigoletto*) si dhe të vërejnë se vihet tek shfaqja e drejtimit të ri në zhvillimin e operës. Mësuesi duhet t’i informojë nxënësit se si quhet ai drejtim (verizëm) dhe se krijuesi i tij është Maskanji dhe i njeh me kuptimin e termit verizëm. Në tabelë shkruan termin verizëm dhe nga cila fjalë vjen (vero - i vërtetë).

Mësuesi u njofton nxënësve/eve edhe një tjetër përfaqësues të verizmit (Ruxhero Leonkavallo) dhe kontributin e tij në zhvillimin e këtij drejtimi me operën “*Pajaci*”. Mësuesi shkruan në tabelë emrin e kompozitorit dhe emërtimin e operës së tij më të rëndësishme. Nxënësit njihen nga Teksti mësimor me jetën dhe krijimtarinë e Pjetro Maskanjit dhe Ruxhero Leonkavallos, përfaqësuesve më të rëndësishëm të verizmit.

3. Pas dëgjimit të aries së Puçinit “*Dhe yjet kanë ndriçuar*” kërkon nga nxënësit/et që të komentojnë arien (për cilin zë është shkruar, si është pjesa vokale, si është përcjellja) dhe pastaj në tabelë shkruan emrin e kompozitorit dhe emërtimin e operës. Pasi njihen me libretin e operës “*Toska*” nga libri, kërkon nga nxënësit/et që ta krahasojnë me libretin e operës së mëparshme, si dhe të vërejnë se mbi çfarë parametrash, Puçini, me këtë vepër, i afrohet operës veristike.

4. I ndan nxënësit në shumë grupe dhe u jep detyrë që secila prej tyre të përqëndrohet në jetën dhe krijimtarinë e Maskanjit, Leonkavallos dhe Puçinit, ndërsa pastaj të këmbëjnë informacionet dhe njohuritë që kanë fituar.

Pamja e tabelës:

Verizmi (vero – i vërtetë)

Pjetro Maskanji

- Kavaleria rustikana

Ruxhero Leonkavallo

- Pajaci

Xhakomo Puçini

- Toska

Zhvillimi i operës franceze

Xhakomo Majerber, Zhorzh Bize

Qëllimet e orës mësimore:

1. Fitimi i njohurive mbi zhvillimin e operës në Francë në shekullin e 19-të
2. Të njohin krijimtarinë e Xhakomo Majerberit dhe të Zhorzh Bizesë

Dëgjimi i muzikës:

1. Zh. Bize - Uvertura nga opera “*Karmen*”
2. Zh. Bize - Aria e Hanaberit “*Dashuria është zog me krahë të lehtë*”

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. njohja me krijimtarinë e Zh. Bizesë
3. formimi i grupeve dhe raportimet

1. Ora fillon me një fragment të shkurtër nga uvertura për operën “*Karmen*” dhe pastaj kërkon nga nxënësit/et të shprehin përjetimin e vet. Udhëzon nxënësit/et që të përqendrojnë vëmendjen në përbërjen e orkestrës (orkestra e madhe me rol të shprehur të elementeve perkusionale), trajtim i ritmit (ndikimi i valles spanjolle) dhe i melodisë (ndikimi i folklorit spanjoll). Në tabelë shkruhet emri i kompozitorit dhe periudha (Zhorzh Bize, gjysma e dytë e shekullit të 19-të). Informon nxënësit/



et se në gjysmën e parë të shekullit të 19-të, në Fancë, ka krijuar Xhakomo Majerber dhe në tabelë shkruan emrin e kompozitorit dhe periudhën në të cilën ka krijuar.

Kërkon nga nxënësit/et, që në bazë të të dhënave nga Teksti mësimor, të informohen për Xhakomo Majerberin dhe të përcaktojnë rolin e tij në zhvillimin e operës (ka ndikuar në shumë kompozitorë të operës, para së gjithash tek Zhorzh Bizea dhe pastaj edhe në Rikard Vagnerin).

2. Pas dëgjimit të aries “Habanera” nga opera “*Karmen*” e Bizesë, në tabelë shkruan emërtimin e operës dhe pranë saj emrin e Zhorzh Bizesë. Pastaj bisedohet me nxënësit/et për përjetimin nga ana e tyre të këtij kompozimi. Kërkon që të përshkruajnë skenën, skenografinë, kostumografinë, lëvizjet skenike. Para dëgjimit të dytë dhe shikimit kërkon nga nxënësit/et që të lexojnë tekstin e aries dhe të thonë mendimin e vet për lidhjen e muzikës me tekstin.

Pasa dëgjimit të dytë, duhet të përgjigjen se kush merr pjesë në skenën e përmendur, të përshkruajnë ritmin (i gjallë, me karakter valleje), të vërejnë përdorimin e instrumentit karakteristik për mjedisin spanjoll (kastanjetat) trajtimin vokal të pjesës (shumë i zhvilluar- koloratural). Pyet nxënësit sesi e kanë përjetuar rolin e vallëzimit në skenën e sipërpërmendur.

Kërkon nga nxënësit që të lexojnë libretin e operës “*Karmen*” dhe me komente të përbashkëta, të krijuara para së gjithash, mbi bazën e pyetjeve për tipat e personazheve (personazhet nga margjinat), karakterit të libretit (tregimi i së vërtetës) do të vinë deri tek përfundimi se opera është e afërt me tipin veristik të operës dhe “*Toskës*”, dhe i lidh me orën e mëparshme.

3. I ndan nxënësit/et në grupe dhe u jep detyrë që nga dy grupe të kenë detyrim të njëjtë:

- grupi i parë dhe i dytë kanë për detyrë që, duke shfrytëzuar Tekstin mësimor, të informohen mbi zhvillimin e operës në gjysmën e parë të shekullit të 19-të dhe veprën e Majerberit (cilin tip të operës ka krijuar, vepra më e njohur, në cilin kompozitor të njohur ka ndikuar...);
- grupi i tretë dhe i katërt kanë për detyrë që në të njëjtën mënyrë të punojnë të dhënat për Zhorzh Bizenë (për jetën e tij dhe lidhjen me Xhuzepe Verdin...).

Nga grupet që kanë të njëjtën detyrë, raporton ai që e ka kryer më parë, ndërsa grupi i dytë plotëson atë, që sipas mendimit të tyre, nuk është thënë.

Pamja e tabelës:

Gjysma e parë e shekullit të 19-të:

Xhakomo Majerber
- Hugenotët

Gjysma e dytë e shekullit të 19-të:

Zhorzh Bize
- Karmen

Vërejtje: Aria “Habanera” – “*Dashuria është zog me krahë të lehtë*” e Zhorzh Bizesë mund të shihet në videokasetën “Opera 1 dhe 2” të cilën e ka përgatitur Mirjana Ivanoviq, në botimin e Entit të teksteve dhe mjeteve mësimore të Serbisë.

Zhvillimi i operës gjermane

Karl Maria fon Veber, Rikard Vagner

Qëllimet e orës mësimore:

1. Fitimi i njohurive mbi zhvillimin e operës në Gjermani në shekullin e 19-të
2. Fitimi i njohurive mbi krijimtarinë e Karl Maria fon Veberit dhe Rikard Vagnerit

Dëgjimi i muzikës:

1. V. A. Moxart: Aria “*Mbretëresha e natës*”, opera “*Flauti magjik*”
2. K. M. Fon Veber: Uvertura nga opera “*Shigjetari magjik*”
3. K. M. Fon Veber: Kori i gjuetarëve nga opera “*Shigjetari magjik*”
4. R. Vagner: Uvertura nga opera “*Tanhozjer*”
5. R. Vagner: Kori i pelegrinëve nga opera “*Tanhozjer*”

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. njohja me operën kombëtare gjermane dhe krijuesin e saj K. M. Veberin
3. njohja me zhvillimin e dramës muzikore dhe me operat e Rikard Vagnerit
4. formimi i grupeve dhe organizimi i pyetësorit.

1. Pas dëgjimit të fragmentit të aries “*Mbretëresha e natës*” nga opera “*Flauti magjik*” e Moxartit kërkon nga nxënësit/et të vërejnë se në cilën gjuhë është shkruar libreti (në gjuhën gjermane). I pyet nxënësit/et se në cilën gjuhë janë shkruar deri atëherë operat (gjuhën italiane). I udhëzon nxënësit/et se me këtë operë të Moxartit është përgatitur rruga për krijimin e operës kombëtare gjermane, e cila do të shfaqet vetëm në shekullin e 19-të.

2. Nxënësve u lëshon një fragment nga uvertura e operës “*Shigjetari magjik*” të Veberit. Bisedon si e kanë përjetuar dëgjimin e kësaj pjese dhe pastaj shkruan në tabelë emërtimin e kësaj opere dhe emrin e kompozitorit: Karl Maria fon Veber dhe shekullin në të cilin ka jetuar. Kërkon të caktojë se për cilën përbërje është shkruar dhe çfarë zhanri është. I pyet nxënësit/et se si quhet muzika hyrëse në operën që e ekzekuton vetëm orkestra (uvertura) dhe përsërit njohuritë që kanë për këtë formë.

Nga Teksti mësimor informohen mbi përmbajtjen e operës dhe pastaj lëshon fragmentin nga pjesa “*Kori i gjuetarëve*”. Bisedohet për përjetimin pas dëgjimit të shembullit të përmendur dhe pastaj i fut nxënësit/et që të njohin gjuhën, karakteristikat e muzikës, elementet folklorike dhe trajtimi i korit.

I njofton se opera “*Shigjetari magjik*” është opera e parë kombëtare gjermane, sepse përdor gjuhën gjermane, tematika është legjenda e vjetër gjermane, si dhe meloditë janë të frymëzuara nga folklori (elementet e folklorit kombëtar).

3. Pas dëgjimit të fragmentit të uverturës bisedon me nxënësit/et si e kanë përjetuar muzikën, për përbërjen ekzekutive (përbërje e madhe orkestrale, me rol të rëndësishëm të veglave muzikore me fryrje) dhe pastaj në tabelë shkruan emërtimin e operës, emrin e Rikard Vagnerit dhe shekullin në të cilin ka jetuar. I udhëzon të dëgjojnë uverturën dhe kërkon që ta krahasojnë me uverturën e



operës “*Shigjetari magjik*” (përbërja e orkestrës, roli i instrumenteve të veçanta në orkestër, raporti ndaj temave). Pas komentimit nga nxënësit/et për rolin e orkestrës, i njih se ajo është njëra nga elementet e ndryshimit që solli Wagneri në operë. Lëshon përsëri fragmentin e uverturës dhe kërkon nga nxënësit/et që pas dëgjimit të kujdesshëm të përcaktojnë se sa fusha tematike ka dhe, nëse disa prej tyre dallohen (përsëriten shumë herë). U theksohet nxënësve se këto tema quhen *lajtmotive* (motive kryesore) dhe se ky është elementi i dytë i reformës së tij. Meqenëse futi sistemin e lajtmotiveve, i udhëzon nxënësit/et se për këtë arsye, aktet nuk ndahen më në numera, por në skena.

Pas dëgjimit të fragmentit të pjesës “*Kori i pelegrinëve*” nga opera “*Tanhozzer*” të Rikard Vagnerit bisedohet mbi përjetimin e muzikës dhe pastaj u njoftohet emërtimi i veprës dhe emri i kompozitorit, pastaj lexohet nga Teksti mësimor libreti dhe kërkon prej nxënësve/eve që të konkludojnë se çfarë teme është (mitologjike). Kërkon nga nxënësit/et të lexojnë nga Teksti mësimor emërtimet e operave me përmbajtje mitologjike duke u thënë se të gjitha këto janë opera të reformuara dhe bashkë me gjithë elementet e mëparshme reformuese janë të njohura me emrin drama muzikore (muzika e dramës).

4. Formon grupet, ndan detyrat dhe formën e organizimit të kuizit:

Grupi I duhet të mendojë pyetjet për grupin II në lidhje me:

a) operën e parë gjermane;

b) karakteristikat e shembujve të korit që kanë dëgjuar (gjuha, tematika, karakteristikat e muzikës);

Grupi II do të duhej të mendonte pyetjet në lidhje me:

a) uverturat e Veberit dhe të Vagnerit (përbërja orkestrale, roli i instrumenteve);

b) reformën e Vagnerit;

Grupi III do të duhej të kishte rolin e jurisë që të ndjekë me kujdes pyetjet dhe të shënojë vërejtjet, që në fund të kuizit të komentojë formën e pyetjeve, saktësinë e tyre si dhe saktësinë e përgjigjes dhe në bazë të këtyre parametrave të marrë vendimin se cili grup është më i miri.

Pamje e tabelës:

Opera kombëtare:

- tematika kombëtare
- gjuha popullore
- melodia folklorike

Karl Maria fon Veber

- *Shigjetari magjik*

Reforma e operës:

Rikard Vagner

risitë:

- aktet i ndan në skena
- fut lajtmotivet
- i jep rol të rëndësishëm orkestrës
- drama muzikore

Vërejtje: Për punimin e kësaj njësie mësimore mund të planifikohen 2 orë.

Opereta

Johan Shtarusi (Biri)

Qëllimet e orës mësimore:

1. Fitimi i njohurive për operetën, formën muzikore-skenike
2. Fitimi i njohurive për krijimtarinë e Johan Shtrausit (Biri)

Dëgjimi i muzikës:

1. Johan Shtrausi (Biri) : “*Miu i verbër*”, kori përmyllës nga finalja e aktit III.

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. njohja me operetën “*Miu i verbër*” të J. Shtrausit (Biri).
3. ndarja në grupe

1. Pas dëgjimit të korit përmyllës nga finalja e aktit III, kërkon nga nxënësit/et që të shprehin përjetimin e vet muzikor dhe u thotë të përqendrojnë vëmendjen se për çfarë përbërje është shkruar shembulli dhe i çfarë karakteri është. I njeh nxënësit/et se shembulli i përmendur paraqet njërin nga numerat në formën që quhet opereta. Të shkruhet në tabelë opereta, emri i kompozitorit dhe veprat që kanë dëgjuar. Pas kësaj nxënësit/et mund të informohen nga Teksti mësimor për këtë formë dhe zhvillimin e saj.

2. Kërkon nga nxënësit/et të lexojnë përmbajtjen e operetës ”*Miu i verbër*” dhe pastaj pyet nxënësit/et se përse opereta e ka marrë këtë emërtim. Fut nxënësit/et që të komentojnë kohën e ballove dhe maskenbaleve dhe në bazë të dhënave nga Teksti mësimor, ato fakte i lidhin me emrin e Johan Shtarusit. Kërkon nga nxënësit/et që të thonë disa nga valset e njohura të Shtrausit që kanë qenë më të famshmet në ballot.

3. Nxënësit/et i ndan në tri grupe:

grupi i parë ka për detyrë të përgatisë hapa të thjeshtë vallëzimi;

grupi i dytë të përgatisë përcjelljen ritmike;

grupi i tretë përgatit maskat që do të mbaheshin në maskenbal në operetën “*Miu i verbër*”.

Pamja e tabelës:

Opereta:

Johan Shtraus (Biri)

- Miu i verbër



BALETI NË KOHËN E ROMANTIZMIT

Adolf Adam, Pjetër Iliç Çajkovski

Qëllimet e orës mësimore:

1. Fitimi i njohurive për formën muzikore-skenike - baletin
2. Fitimi i njohurive për krijimtarinë e Adolf Adamit, Leo Delibit dhe Pjetër Iliç Çajkovskit

Dëgjimi i muzikës:

1. A. Adam: baleti “*Zhizel*”
2. P. I. Çajkovski: baleti “*Liqeni i mjellmave*”

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. njohja me zhvillimin e baletit në Francë
3. njohja me baletin në Rusi
4. bashkëbisedim

1. Në pjesën hyrëse të orës nxënësit dëgjojnë nga CD-ja fillimin e baletit “*Zhizel*” të A. Adamit dhe kërkohet nga nxënësit të komentojnë shembullin që kanë shikuar dhe i fut të nxjerrin se për cilin zhanër është fjala (baleti). Në tabelë shkruan emrin e baletit, të kompozitorit dhe të shtetit që përfaqëson (Franca). I pyet nxënësit/et se kur përmendet për herë të parë emri i baletit dhe në kuadër të cilit zhanër (operës). Mbi bazën e shembullit të dëgjuar dhe të shikuar të shembullit të përmendur, i fut nxënësit të konkludojnë se është fjala për baletin e bardhë, në bazë të kostumeve të balerinave, si edhe të vërejnë se kush e ka përparësinë në skenë, balerinat apo balerinët.

2. Pas dëgjimit të shembullit nga baleti “*Zhizel*” u kërkon nxënësve që të lexojnë libretin e baletit. Përsëri u lëshon shembullin dhe kërkon prej tyre të shprehin përjetimet e veta (i orienton nga përjetimi muzikor dhe skenik).

Mësuesi njofton emrin edhe të një kompozitori të rëndësishëm të baletit francez (Leo Delib), shkruan në tabelë emrin e tij dhe emërtimin e baletit më të rëndësishëm të tij (*Kopelia*). Mbi bazën e të dhënave në Tekstin mësimor, nxënësit informohen për jetën dhe krijimtarinë e Leo Delibit.

3. Lëshon një fragment nga baleti “*Liqeni i mjellmave*”. Pas dëgjimit të fragmentit, nis bisedën me nxënësit/et për përjetimin nga ana e tyre të muzikës dhe pastaj u thotë se baletin e ka shkruar P. I. Çajkovski. Në tabelë shkruan emrin e kompozitorit, emërtimin e baletit dhe origjinën nga rrjedh (Rusia).

Kërkon nga nxënësit /et të lexojnë libretin e baletit “*Liqeni i mjellmave*” dhe pastaj lëshon shembullin nga baleti “*Liqeni i mjellmave*” dhe udhëzon nxënësit/et që për baletet e tjera të Çajkovskit

të informohen nga Teksti mësimor. Mbi bazën e informatave që marrin nga Teksti mësimor, titujve të baletëve, fut nxënësit/et që të përcaktojnë tematikën e baletëve të tjera të Çajkovskit (fantazia, përralla).

4. Organizon bisedën mbi jetën dhe punën e kompozitorëve të përmendur. Duke shfrytëzuar të dhënat nga Teksti mësimor dhe në bazë të shembujve të dëgjuar dhe të shikuar, kërkon nga nxënësit/et që të krahasojnë baletet “*Zhizel*” dhe “*Liqeni i mjellmave*” (sipas tematikës, numrit të akteve, skenografisë, kostumografisë, koreografisë).

Përmes formës së bisedimit me nxënësit/et mëson, nëse kanë parë ndonjë shfaqje baleti direkt ose në televizion dhe si janë përshtypjet e tyre.

Pamje e tabelës:

Baleti

- Shekulli i 19-të

Franca

Adolf Adam

- Zhizel

Leo Delib

- Kopelia

Rusia

Pjetër Iliç Çajkovski

- Liqeni i mjellmave

Vërejtje: Fragmentet nga baleti “*Zhizel*” të Adolf Adamit dhe “*Liqeni i mjellmave*” të Pjetër Iliç Çajkovskit mund të shikohen në videokasetën “Baletet”, të përgatitur nga Mirjana Ivanoviq, në botimin e Entit të teksteve dhe mjeteve mësimore të Serbisë.



Është rritur në Novi Portokalli

Qëllimi i orës mësimore:

Mësimi i këngës sipas partiturës me nota

Dëgjimi i muzikës

1. *Është rritur në Novi portokalli (Uzrasla mi u Novi naranča)* – këngë popullore nga Mali i Zi, Boka e Kotorit (ekzekutim vokalo-instrumental)

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse
2. punimi i këngës “*Është rritur në Novi portokalli*” (*Uzrasla u Novi naranča*) sipas partiturës me nota
3. formimi dhe raportimi i grupeve

1. Me qëllim që të krijohet atmosfera e përshtatshme për punimin e këngës tradicionale, ora të fillojë me përsëritjen e këngës “*O, moj vajzë e gëzuar*” (*Oj, vesela veselice*). Pas kësaj mësuesi/ja i lajmëron për këngën e re “*Është rritur në Novi portokalli*” (*Uzrasla u Novi naranča*) dhe tregon shkrimin me nota të saj në tabelë ose në karton. Mbi bazën e analizës së tekstit të këngës, nxënësit/et do të vijnë vetë në përfundimin se për cilin lloj të këngës është fjala (këngë dasme).

2. Punohet kënga e re sipas procedimit metodik të punimit të këngës me tekstin me nota.

3. Të formohen katër grupe, me detyrën që secili grup të vërejë se cilat janë ndryshimet mes këngës “*O, moj vajzë e gëzuar*” (*Oj, vesela veselice*) dhe “*Është rritur në Novi portokalli*” (*Uzrasla u Novi naranča*) (karakteri, melodia, ritmi, temp), si dhe të lidhen karakteristikat e këngëve me krahinat nga rrjedhin.

4. Pas komentimit të nxënësve/eve lëshon regjistrimin me zë nga CD-ja, me qëllim që nxënësit të fitojnë përshtypjen e përgjithshme tingullore të këngës tradicionale. Komentohe si tingëllon kënga, nëse atmosfera e saj i përshtatet traditës, zakonisht (dasmës) dhe përshkruajnë përjetimin e vet pasi të dëgjojnë këngën.

MUZIKA NË MALIN E ZI NË SHEKULLIN E 19-TË

Qëllimi i orës mësimore:

Fitimi i njohurive për zhvillimin e muzikës në Malin e Zi në shekullin e 19-të

Dëgjimi i muzikës:

1. D. Di Sarno: Uvertura për “*Perandoreshën e Ballkanit*”
2. M. Petroviq: *Vallja ime*
3. M. Petroviq: *Fati i humbur*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi analitik dhe bisedë rreth kompozimeve të dëgjuara
3. formimi i grupeve, raportimet

1. Në pjesën hyrëse të orës, me nxënësit të bisedohet për situatat historike e shoqërore në Malin e Zi në shekullin e 19-të dhe pastaj të informohen për situatën muzikore në Mal të Zi në këtë periudhë kohore. Pastaj dëgjohet uvertura për “*Perandoreshën e Ballkanit*”. U kujton nxënësve/eve se cila është forma e kompozimit të dëgjuar dhe kërkon nga ata që, në bazë të njohurive të fituara, të japin karakteristikat kryesore të uverturës (muzika hyrëse për operën dhe ndonjë kompozim më të madh). Fut nxënësit/et të thonë se cilën uverturë kanë dëgjuar në njërin nga orët e mëparshme (F. Mendelson: *Ëndërr e një natë vere*). Shkruan në tabelë emrin e kompozitorit dhe emërtimin e kompozimit.

2. Pas pjesës hyrëse vazhdon dëgjimi i uverturës. Kërkon nga nxënësit/et të përshkruajnë përjetimin e vet gjatë dëgjimit të këtij kompozimi. I nxit që të vërejnë se është fjala për kompozimin instrumental dhe se e ekzekuton orkestra. Pastaj kërkon nga nxënësit /et që të përshkruajnë se si është melodia e tij dhe nëse ndjehet apo jo përdorimi i elementeve folklorike.

Më vonë, u lëshon kompozimin e M. Petroviqit “*Vallja ime*” dhe u kërkon nxënësve/eve që të bëjnë dallimin mes këtij dhe kompozimit të mëparshëm (të shkruar për zë me përcjellje të orkestrës). Kërkon të përshkruajnë se çfarë përjetimi zgjon ky kompozim tek ata. I pyet nëse një formë të tillë e kanë dëgjuar në orën (Kënga solo e Shubertit “*Gogoli*”). Shkruan në tabelë emrin e kompozitorit dhe emërtimin e kompozimit.

Lëshon për nxënësit/et incizimin e kompozimit të M. Petroviqit “*Fati i humbur*”. Kërkon prej tyre që të bëjnë krahasimin e këtyre dy kompozimeve sipas ekzekutuesve (ekzekutuesi femër dhe mashkull) dhe të tregojnë si e kanë përjetuar kompozimin. Shkruhet në tabelë emërtimi i kompozimit. Pastaj mësuesi dhe nxënësit/et definojnë karakteristikat e elementeve konstruktive të kompozimit: melodinë, ritmin, tempin, dinamikën, analizon raportin mes atyre elementeve me tekstin e këngës dhe nxjerr përfundimin se cili është karakteri i kompozimit.

3. Nxënësit/et i ndan në shumë grupe me detyrën që çdo grup, në bazë të kompozimeve të



dëgjuara të thonë karakteristikat e muzikës në Malin e Zi në kohën e romantizmit (melodia, karakteri, tempi, përbërja e orkestrës etj.). Kërkon që t'i krahasojnë me kompozimet që kanë dëgjuar gjatë vitit (ngjashmëritë dhe dallimet). Pas këmbimit të informatave në kuadër të grupit, përfaqësuesit e grupeve raportojnë për njohuritë deri tek të cilat kanë ardhur.

Pamja e tabelës:

Dionis de Sarno

- Perandoresha e Ballkanit, uverturë

Mirko Petroviq

- Vallja ime, këngë solo

Muzikantët e huaj më të rëndësishëm:

Antun Shulc, Franjo Vimer, Robert Tolinger, Dionis de Sarno

Muzikantët malazezë më të rëndësishëm:

Mirko Petroviq, Jovan Ivanisheviq

Shkapërceva dy-tri male

Qëllimet e orës mësimore:

1. Mësimi i këngës sipas partiturës me nota
2. Përgatitja e përcjelljes ritmike

Dëgjimi i muzikës:

1. *Shkapërceva dy-tri male*- këngë popullore shqiptare (ekzekutim vokalo-instrumental)

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. punimi i këngës “*Shkapërceve dy- tri male*” sipas partiturës me nota
3. formimi i grupeve dhe ekzekutimi
4. dëgjimi i muzikës

1. Në pjesën hyrëse të orës, mësuesi/esja do të kërkojë nga nxënësit/et të këndojnë këngën e njohur “*Xhamadani*” që e kanë mësuar në klasën e mëparshme ose një motiv të caktuar melodik, i cili përsëritet me radhë në çdo ton të shkallës muzikore, në bazë të së cilës është melodia e këngës që duhet të punohet.

2. Punohet kënga e re me procedimin e njohur metodik. Dëgjojnë me vëmendje shqiptimin e tekstit të saj.

3. Në bazë të asaj çfarë ka në dispozicion shkolla, d.m.th. sipas llojit të goditëseve që ka (rraketake, dajre, triangël, kastanjeta) i ndan nxënësi/et në grupe me detyrën që të improvizojnë, modelojnë përcjelljen ritmike. Pas kësaj, të këndojnë këngën me përcjelljen ritmike që e kanë menduar vetë.

4. Në fund të orës të dëgjohet regjistrimi me zë nga CD-ja, me qëllim që nxënësit/et të dëgjojnë këngën në ekzekutimin origjinal. Kërkon prej tyre të përshkruajnë përjetimin e vet pas dëgjimit të këngës dhe ta krahasojnë me këngët popullore të mësuara më parë. (*O, moj vajzë e gëzuar (Oj, vesela veselice)*, *Është rritur në Novi portokalli (Uzrasla je u Novi naranča)*).



Literatura:

- Xh. Abraham: *Historia e muzikës e Oksfordit*, CLIO, 2001
- J. Andreis: *Historia e muzikës*, Liber Mladost, Zagreb, 1974
- M. Vasileviq: *Melodi popullore të Malit të Zi*, Instituti muzikologjik, Beograd, 1965
- O. Gjuriq: *Udhëzues për historinë e muzikës*, shtypshkronja ushtarake, Beograd, 2001
- Eberst: *Paleta muzikore*, Prosveta, Novi Sad, 1985
- K. H. Ehrenforth: *Zhvillimi i pedagogjisë së muzikës*, SCHOTT, 2005
- *Leksikoni enciklopedik, Mozaik njohurish, Arti muzikor*, Interpres, Beograd, 1972
- J. Zec: Pjetër Iliç Çajkovski, *Rinia muzikore e Serbisë*, Beograd, 2000
- R. Kamien: *Music an appreciaton*, Mc Graw Hill, USA, 1996
- S. Marinkoviq: *Historia e muzikës*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore të Serbisë, Beograd, 1997
- M. Milojeviq: *Studimet muzikore dhe elementet*, Libri i tretë, Beograd, 1953
- T. Popoviq-Mllagjenoviq: *Dhe yjet kanë ndriçuar*, Milprom
- M. Mihajlloviq: *Format muzikore për shkollat e mesme të muzikës*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, Beograd, 1998
- *Enciklopedia muzikore*, Enti i leksikografisë jugosllave, Zagreb, 1971-77.
- R. Pejoviq: *Historia e muzikës*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore të Serbisë, Beograd
- D. Plavsha: *Muzika, e kaluara, e tashmja, personalitetet, format*, Nota Knjazhevac, 1981
- D. Pogue, S, Speck: *Muzika klasike për jo kopetentët*, Mikroknjiga, Beograd, 2000
- *Regjistri i libreteve të operës dhe të baleteve*, Paidea, Beograd, 1999
- F. Zh. Salazar: *Ideologjitë në operë*, Nolit, Beograd
- D. Stojanoviq – Noviçiq: *Xhuzepe Verdi, Rinia muzikore e Serbisë*, Beograd, 2002
- D. Skovran, V. Periçiq: *Shkenca e formave muzikore*, Universiteti i artit, Beograd, 1986
- J. Shulhof: *Libri për operat*, Ndërmarrja botuese “Bratstvo-Jedinstvo”, Novi Sad